

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 5980  
E hënë, 20 janar 2020  
çmimi 0.40 €

Thaçi: Kurti të reflekttojë,  
qytetarët dhe  
ndërkombëtarët po presin  
formimin e qeverisë



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAIK KAMBERI | FAQE 4-5

## SYNOJTMË MË SHUMË SE DY DEPUTETË SHQIPTARË NË PARLAMENTIN SERB



Kryetari i Partisë për Veprim Demokratik (PVD), Shqip Kamberi, ka bërë me dije se nga unifikimi i spektrit politik në Luginë të Preshevës, shqiptarët presin që t'i kenë më shumë se dy deputetë në parlamentin serb. Në

këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se garimi i katër subjekteve me një listë të unifikuar zgjedhore në zgjedhjet parlamentare të Serbisë ka për qëllim përfaqësim më të fuqishëm të shqip-

tarëve në institucionin qendror shtetëror. Kamberi, i cili është edhe kryetar i Komunës së Bujanocit, ka vlerësuar se ky veprim do të ndikojë në faktorizimin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës

### OPINION

SHTIGJET E PËRFLAKURA  
TË JANARËVE TË LIRISË F. 10

Mehmet  
HAJRIZI



DIPOLET MAGNETIKE F. 11

Shkruan: Naim  
KRASNIQI, fizikan



### AKTUALE

AMBASADORI WALKER IA  
TREGOI TËRË BOTËS TË  
VËRTETËN PËR KRIMET E  
SERBISË F. 7



OPERACION I RRALLË KRYHET  
NË KIRURGJI VASKULARE F. 7

### EKONOMI

SHUMICA E BIZNESEVE ENDE  
PA ARKA FISKALE F. 8

### KULTURË

ORIENTIMET E ÇABEJT F. 13

Begzad  
BALIU



POLITIKA E BRENDSHME DHE E  
JASHTME E SKËNDERBEUT F. 15

Nexhat KRASNIQI



## FAMILJA NGA ISTOGU JETON NË VARFËRI TË SKAJSHME, KËRKON NDIHMËN E QYTETARËVE

Familja shtatanëtarëshe e Jahir Morinës nga Baica e Istogut jeton në kushte skajshmërisht të rënda ekonomike dhe sociale. Në kohën kur temperaturat shënojnë në minus gradë celsius, kësaj familjeje,

pos ushqimit, veshmbathjeve dhe gjërave higjienike, i mungojnë edhe drunjtë e zjarrit. Shtëpia e saj kundërmon në të katër anët, pasi çdo pikë shiu depërton në muret dhe shtretërit e shtëpisë.

Kurse ndihma sociale prej 125 eurosh nuk i mjafton për t'i ushqyer dhe veshmbathur pesë fëmijët, tregon për gazetën "Epoka e re" bashkëshortja e Jahir Morinës, Drita | FAQE 8-9

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Kurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



# Shqiptarët e Luginës synojnë 4 deputetë në Parlamentin serb

Arritja e marrëveshjes mes katër subjekte politike shqiptare është pikënisje për të synuar fuqizimin e zërit të votuesve shqiptarë që jetojnë në Luginën e Preshevës e që mundet të sjellë tre deri në katër deputetë në Parlamentin serb

PRISHTINË, 19 JANAR - Katër subjekte politike shqiptare të komunave: Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë në Serbi, që njihet si Lugina e Preshevës, janë marrë vesh që të garojnë me një listë të unifikuar zgjedhore në zgjedhjet parlamentare të Serbisë, të cilat pritet të mbahen në pranverë e këtij viti.

Arritja e marrëveshjes sipas tyre është pikënisje për të synuar fuqizimin e zërit të votuesve shqiptarë që jetojnë në Luginën e Preshevës.

Marrëveshja ndërmjet Partisë për Veprim Demokratik, Alternativës për Ndryshim, Lëvizjes për Progresin Demokratik dhe Lëvizjes për Reforma e Partisë Demokratike Shqiptare, është arritur të enjten, në Tiranë, me ndërmjetësimin e ministrit në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Gent Cakaj.

Shqipërim Arifi, kryetar i komunës së Preshevës, i cili vjen nga radhët e Alternativës për Ndryshim, thotë për "Radion Evropa e Lirë" që pas arritjes së kësaj marrëveshjeje, qëllimi i liderëve të këtyre partive politike është që problemet që ekzistojnë në Luginën e Preshevës, për të cilat jo rrallë vetë këta liderë janë grindur mes vete, ato t'i bartin në Parlamentin e Serbisë.

"Ideja është që shqiptarët në Parlamentin e Serbisë, në 10 apo 12 vjetët e fundit, prej kur kanë filluar të marrin pjesë aty në këtë dekadë të këtij shekulli, nuk kanë qenë të përfaqësuar, jo vetëm me numër të mjaftueshëm, por as me kualitetin e mjaftueshëm. Tash është një tjetër situatë. Unifikimi mund të sjellë tre deri në katër deputetë, që e mundëson një grup parlamentar prej 5 deputetësh, duke përfshirë edhe një minoritet tjetër, në Parlamentin e Serbisë. Pastaj, do

të fillojmë ta sjellim kualitetin, të cilin e kërkojmë për shumë vite, për të mos thënë dekada", tha Arifi.

Shaip Kamberi, kryetar i komunës së Bujanocit, nga radhët e Partisë për Veprim Demokratik, thotë se aktualisht shqiptarët e Luginës së Preshevës e kanë vetëm një ulëse në Parlamentin e Serbisë. Në legjislaturat e mëhershme të këtij shteti, sipas tij, ka pasur edhe deputet tjerë shqiptarë, por të paktë dhe të cilët, përveç sensibilizimit të problemeve të shqiptarëve, nuk kanë arritur të imponojnë ndonjë zgjidhje për ato probleme, për shkak të mungesës së kapaciteteve demokratike në Serbi.

"Kësaj radhe, kur pritet që opozita në Serbi t'i bojkotojë zgjedhjet, kur pritet që bisedimet në mes të Kosovës

dhe Serbisë të vazhdojnë pas krijimit të qeverisë në Prishtinë, ne mendojmë - dhe kjo ishte edhe ideja e Tiranës - që fuqizimi i zërit politik të shqiptarëve në parlament do ta ketë një rëndësi dhe një peshë të përfaqësimit e problemeve tona atje. Kjo, për ta detyruar, në radhë të parë Beogradin, duke kërkuar ndihmën edhe nga bashkësia ndërkombëtare, e sigurisht edhe nga Tirana dhe Prishtina, që këto probleme të marrin kahen e zgjidhjes, sepse është krijuar një situatë e pashpresë këtu në Luginën e Preshevës", theksoi Kamberi. Njohësi i zhvillimeve politike në Kosovë, Armend Muja, thotë për "Radion Evropa e Lirë", se marrëveshja e arritur ndërmjet partive politike në Luginën e Preshevës për unifikimin e një liste zgjedhore për pjesëmarrje

në zgjedhjet parlamentare në Serbi, është një përpjekje në drejtimin e duhur, e cila ka gjasa reale që të konkretizohet.

"Unë këtë e shoh si përpjekje, në vazhden e një serie të përpjekjeve që kanë qenë, sikurse te korpuset politike të shqiptarëve në Mal të Zi më herët dhe më pas, tash edhe në Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë. Megjithatë, për ndryshim nga Mali i Zi, ku faktori shqiptar shpeshherë është përcaktues, këtu influenza e tyre gjithsesi, marrë parasysh edhe shtrirjen e tyre të vogël në trupin zgjedhor, do të jetë e vogël. Mirëpo, e rëndësishme është si platformë e unifikimit të qëndrimeve kyçe nacionale për sa u përket të drejtave të tyre në Luginë dhe unë mendoj se kjo është një iniciativë e rëndësishme", u shpreh Muja.



## Oficerët e antiterrorit dëbuan diplomatët spiunë të Iranit

TIRANË, 19 JANAR - Irani i ka sjellë si diplomatë, ndërsa Shqipëria i ka dëbuar si të përfshirë në spiunazh.

"Top Channel" ka mësuar se nën masa të forta sigurie dhe në sekret të plotë oficerët e Drejtorisë së Antiterrorit dhe ShISH-it, mbrëmjen e të shtunës, kanë dëbuar diplomatët Mohammad Ali Arz Peimanemati dhe Seyed Ahmad Hosseini Alast.

Burime në dijeni të këtij operacioni dëbimi i kanë thënë këtij mediumi se 20 oficerë të Drejtorisë së Antiterrorit, kanë shoqëruar të dy diplomatët së bashku me familjet e tyre nga apartamentet ku banonin në

drejtim të Rinasit.

Disa ditë më parë Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme, ka thënë se dy diplomatët iranianë, janë shpallur persona të padëshirueshëm, për shkak të zhvillimit të veprimtarisë në mospërputhje me statusin e tyre. Mohammad Ali Arz Peimanemati, ishte konsull i Ambasadës së Iranit në Shqipëri. Me një të kaluar aspak diplomatike, por i caktuar i tillë, me një qëllim tjetër krejt të kundërt me atë çfarë duhet të bëjë një diplomat. Ai ishte anëtar i njësisë operacionale të inteligjencës së Iranit, e njohur si "QUDS". Seyed Ahmad Hosseini Alast, mbante postin e atashut kultur-

or, por me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë, Drejtorja e Antiterrorit dhe ShISH-ut kanë marrë të dhëna se Alast kishte mbajtur poste të larta në Gardën Revolucionare të Republikës Islamike.

Shqipëria ka shpallur person "non-grata" në dhjetor 2018 edhe Gholamhossein Mohammadnia ambasador i Iranit Shqipëri nën dyshimin se ishte agjent i shërbimeve sekrete iraniane duke e dëbuar.

Të njëjtin fat ka pasur edhe Mostafa Roudaki, një tjetër diplomat ish-sekretar i Ambasadës së Iranit në Shqipëri, duke u dëbuar në dhjetor 2018.

Zëvendësndihmës sekretari



amerikan i Shtetit dhe i dërguari i veçantë për Ballkanin Perëndimor, Mattheë Palmer në takimin me ambasadorin e re amerikane, Yuri Kim, e ka vlerësuar si "qëndrim të guximshëm

dhe parimor të Shqipërisë mbi Iranin" dëbimin e dy diplomatëve.

Po ashtu edhe DASH-i ka përsëritur dëbimin e tyre nga Tirana.

# Thaçi: Kurti të reflektojë, qytetarët dhe ndërkombëtarët po presin formimin e qeverisë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të dielën se qytetarët dhe partnerët ndërkombëtarë janë duke pritur që të formohen institucionet. Ai ka theksuar se Kurti duhet të pranojë ose refuzojë ta formojë qeverinë e re bazuar në rezultatet e 6 tetorit. "Shpresoj se Kurti do të reflektojë sepse është në interes të tij dhe elektoratit të tij, në të kundërtën duhet ta deklarojë refuzimin", ka thënë presidenti Thaçi

**EPOKA  
ERE**

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 19 JANAR** - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë të dielën se është në vullnetin e spektrit politik që ta përmbyllë suksesshëm procesin e zgjedhjeve të 6 tetorit. Ai i ka bërë thirrje liderit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, që të reflektojë pasi, sipas tij, qytetarët dhe ndërkombëtarët po presin formimin e qeverisë së re. Thaçi ka thënë se në të kundërtën Kurti duhet ta deklarojë refuzimin për mandatar. "Unë do ta respektoj Kushtetutën dhe ligjin e Kosovës dhe autoritetin tim të plotë si president i vendit që buron prej Kushtetutës së Kosovës. Natyrisht se tash i mbetet kryetarit të partisë fituese që ta bëjë hapin dhe në këtë drejtim ka qenë edhe takimi ynë së bashku me kryetarin e partisë së parë, ku ka premtuar se në ditët në vijim do ta pranojë edhe kuptimin juridik - përgjegjësinë e mandatarit për themelimin e qeverisë. Kaluam një kohë të gjatë dhe qytetarët janë duke pritur. Edhe miqtë ndërkombëtarë gjithashtu. Koha po kalon, prandaj unë si president i vendit, duke parë angazhimet e kryetarit të partisë që ka dalë fituese nga zgjedhjet dhe që ka nominuar më shumë se gjysmën e kabinetit të tij dhe unë e kam shkruar nominimin e tij si kryeministër dhe ai nominim është ende në zyrën e tij, shpresoj se Kurti do të reflektojë sepse është në interes të tij dhe elektoratit të tij, në të kundërtën duhet ta deklarojë refuzimin", ka thënë presidenti Thaçi pas takimit me ish-ambasadorin e OSBE-së në Kosovë, William Walker.

**Nagavci: Qeveri të mandatuar nga LV-ja ose zgjedhje të reja**

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, ka thënë se presidenti Hashim Thaçi, duke qenë i anshëm dhe kundër LV-së, po dëshiron të krijojë huti te qytetarët e presion te

LV-ja. Ajo përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se çështja është e qartë dhe nuk ka nevojë që presidenti i vendit të bëjë presion apo të krijojë huti në kuptim të së drejtës për ta propozuar mandatarin. "Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës e ka zgjidhur edhe çështjen e shumicës së Kuvendit, e cila, sipas interpretimit, i takon LV-së, e cila ka të drejtën që t'i propozojë kandidatin për mandatar, presidentit të Republikës. Presidenti mund ta dekretojë mandatarin vetëm pasi kjo të ketë ndodhur", ka shkruar ajo, duke theksuar se çështja është e qartë dhe nuk ka nevojë që presidenti i vendit të bëjë presion apo të krijojë huti në kuptim të së drejtës për ta propozuar mandatarin. "Edhe në rastin e parë, sikundër edhe në rastin e dytë, e drejta e propozimit të mandatarit i takon vetëm Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa sa i përket afatit kohor për propozimin e emrit të mandatarit të parë nga ana e LV-së, Kushtetuta është e heshtur", ka thënë Nagavci.

**Mustafa: LV-ja duhet ta vlerësojë mirë ofertën e fundit të LDK-së**

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka folur për arsyet e mosarritjes së koalicionit me Lëvizjen Vetëvendosje deri më tani. Në një intervistë për RTV21, Mustafa ka thënë se nuk e ka pritur që do të zgjasin kaq shumë bisedimet me LV-në për formimin e Qeverisë. Sipas tij, tani koalicioni mund të arrihet me vullnetin e Vetëvendosjes. "LDK-ja ka vullnet edhe përkushtim që të arrihet koalicioni se kemi punuar gjatë për këtë. Kemi kryer një fazë shumë të rëndësishme të punës në harmonizimin e programit qeverisës, në përcaktimin e fushave që do të qeverisin LDK-ja e Vetëvendosje dhe subjektet që iu përkasin minoriteteve. Kanë mbetur disa gjëra që unë si kryetar i LDK-së kam qenë i



bindur se do të zgjidhen dhe do të pajtoheshim në takimin e parë ose të dytë, dhe në asnjë rast nuk kam pritur që do të shkohet kaq gjatë, por vlerësoj se mund të arrihet kjo me vullnetin e partisë që ka dalë e para", ka thënë Mustafa.

Kreu i LDK-së, Mustafa, ka theksuar se LV-ja duhet ta vlerësojë mirë ofertën e fundit të LDK-së

për koalicionin pasi, sipas tij, kjo ofertë është e balancuar. "LV-ja duhet të masë e vlerësojë mirë ofertën që ne kemi dhënë sepse është një ofertë shumë e balancuar që siguron që dy subjektet të kenë participim në organet më të larta përfaqësuese dhe organet qeverisëse të vendit e cila në asnjë rast nuk e dëmton asnjërin palë, por e shton

mirëbesimin dhe mundëson që t'i arrijmë synimet tona. Nëse s'bëhet kjo atëherë do të jetë e pasigurt se si do të funksionojë ky koalicion edhe po të ndodhte koalicioni. Prandaj, presim që kjo të vlerësohet mirë, të matet mirë dhe të kemi përgjigje nga Vetëvendosja që mundëson që ne ta bëjmë koalicionin shumë shpejt", është shprehur Mustafa.



## Meta bën homazhe te varri i ish-presidentit Rugova

**PRISHTINË, 19 JANAR (ER)** - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka bërë homazhe te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova në lagjen "Velania" në Prishtinë. "Me respekt e mirënjohje të thellë u përula me

nderim para memorialit të presidentit historik të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova. Vizioni i tij euroatlantik për Kosovën, kontributet e jashtëzakonshme për paqe, liri, demokraci, për fëmijë e bashkëjetesë në rajon,

janë shembuj frymëzimi, përherë aktuale. Historia e re e Kosovës dhe e kombit shqiptar ka në themelet e veta emrin dhe veprën e ndritur të presidentit Rugova", ka thënë Meta pas homazheve.

Flet për "Epokën e re", Shaip Kamberi

# Synojmë më shumë se dy deputetë

Kryetari i Partisë për Veprim Demokratik (PVD), Shaip Kamberi, ka bërë me dije se nga unifikimi i spektrit politik në Luginë të Preshevës, shqiptarët presin që t'i kenë më shumë se dy deputetë në parlamentin serb. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se garimi i katër subjekteve me një listë të unifikuar zgjedhore në zgjedhjet parlamentare të Serbisë ka për qëllim përfaqësim më të fuqishëm të shqiptarëve në institucionin qendror shtetëror. Kamberi, i cili është edhe kryetar i Komunës së Bujanocit, ka vlerësuar se ky veprim do të ndikojë në faktorizimin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës



**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 19 JANAR** - Kryetari i Partisë për Veprim Demokratik (PVD), Shaip Kamberi, ka mirëpritur marrëveshjen politike për pjesëmarrjen e përbashkët të partive politike shqiptare të Luginës së Preshevës në zgjedhjet e ardhshme parlamentare të Serbisë.

Kamberi, i cili është edhe kryetar i Komunës së Bujanocit, ka thënë se iniciativa e katër subjekteve shqiptare në Luginë ka për qëllim përfaqësim më të fuqishëm të shqiptarëve në institucionin qendror shtetëror. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se

përmes kësaj liste subjektet politike të Luginës së Preshevës synojnë t'i marrin më shumë se dy deputetë. "Reale është të kemi dy mandate, megjithatë ne duhet të synojmë edhe më shumë", ka thënë Kamberi. Ai ka vlerësuar se ky unifikim i spektrit politik shqiptar do të ndikojë në faktorizimin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Sipas Kamberit, kjo do të sjellë edhe mundësi më të madhe të sensibilizimit të bashkësisë ndërkombëtare me situatën reale në Luginë të Preshevës. "Nisur nga ky fakt, synimi ynë me pjesëmarrje në këto zgjedhje, në rend të parë, ka të bëjë me fuqizimin politik të shqiptarëve dhe me mundësinë më të madhe të sensibilizimit të bashkësisë

ndërkombëtare me situatën reale në Luginë të Preshevës, me mundësinë e përdorimit të

të gjitha mekanizmave institucionale për përmirësimin e jetës reale në këtë rajon", është

shprehur Kamberi. Kryetari i PVD-së pret që unifikimi i katër subjekteve

## Kurti mban ligjëratë para 120 studentëve ndërkombëtarë nga Universiteti i Vjenës

**PRISHTINË, 19 JANAR (ER)** - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka mbajtur një prezantim para 120 studentëve ndërkombëtarë nga Universiteti i Vjenës dhe ai i Venedikut, të cilët ishin të shoqëruar nga profesoresha Marijana Gradits. Kurti në këtë ligjëratë ka folur për situatën aktuale politike në vend, duke sqaruar rëndësinë e zgjedhjeve të 6 tetorit, arsyet e vonësës për formimin e institucioneve të reja dhe përpjekjet që po bëhen për formimin e tyre. Ai ka paraqitur para studentëve programin zhvillimor të Lëvizjes Vetëvendosje që në qendër ka krijimin e vendeve të reja të punës dhe shtetndërtimin demokratik me sundim të ligjit. "Prioritet i qeverisë së re do të jetë forcimi i shtetit dhe zvogëlimi i pushtetit", ka theksuar ai në fjalën e tij.

Pas prezantimit të shkurtër, studentët parashtruan pyetjet që zgjeruan diskutimin mbi pikat programore të Lëvizjes Vetëvendosje që lidhen me ekonominë dhe investimet, drejtësinë dhe procesin e vetingut si dhe edukimin dhe sistemin dual të arsimit. Studentët u interesuan edhe për qëndrimet e Lëvizjes për çështje të caktuara ndër vite, për hapat konkretë të Lëvizjes si udhëheqëse e qeverisë së ardhshme, si dhe për marrëdhëniet dhe politikat që bashkojnë komunitetet e ndryshme në Kosovë.

Studentët falënderuan kryetarin Kurti për prezantimin e bërë para tyre dhe përgjigjet në pyetjet dhe çështjet e ngritura nga ta. Kurti i falënderoi ata për ftesën për pjesëmarrje në këtë diskutim dhe për interesimin e treguar.



# shqiptarë në parlamentin serb



politike në një listë për zgjedhjet në Serbi, që do të mbahen në pranverë të këtij viti, do të

ndikojë që shqiptarët të dalin në zgjedhje në numër më të madh. "E thashë se edhe kur

kemi garuar në këto zgjedhje si parti e vetme ne kemi arritur të sigurojmë një mandat në parlament, përkundër pragut relativisht të lartë që kërkohet, prej 11 mijë deri në 15 mijë vota prandaj, kur në këtë iniciativë kemi katër parti politike të grumbulluar nën një ide, besoj se dy mandate do të sigurohen, duke pasur para sysh edhe faktin se në të njëjtën datë në Bujanoc do t'i kemi edhe zgjedhjet lokale të cilat do ta rrisin daljen e elektoratit në zgjedhje", ka thënë Kamberi.

**"Epoka e re":** Z. Kamberi, katër subjekte politike shqiptare të Luginës së Preshevës janë marrë vesh që të garojnë me një listë të unifikuar zgjedhore në zgjedhjet parlamentare të Serbisë. Çka ju shtyri ta bëni këtë unifikim?

**Kamberi:** Fillimisht më duhet të sqaroj se sa i përket Partisë për Veprim Demokratik, vendimi për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare nuk është risi. Në vazhdimësi që nga viti 2007 ne kemi participuar në këto zgjedhje dhe kemi arritur të fitojmë herë një, herë dy mandate. Në tërë këtë periudhë kemi tentuar t'i bindim edhe subjektet e tjera të marrin pjesë, herë pas here, si në vitin 2017, 2008 dhe 2012, dhe kemi pasur sukses kur kemi garuar me emërtimin 'Koalicioni i shqiptarëve të Luginës së Preshevës'. Më 2014 dhe më 2016 kemi marrë pjesë si subjekt i vetëm. Kësaj here,

me angazhimin e drejtpërdrejtë të ministrit Cakaj në Tiranë, është arritur një marrëveshje parimore për pjesëmarrje të përbashkët të katër subjekteve që ka për qëllim përfaqësim më të fuqishëm të shqiptarëve në institucionin qendror shtetëror. PVD-ja, e interesuar që kjo filozofi politike të cilën e ka trasuar me dekada, të pranohet edhe nga partitë e tjera në Luginë të Preshevës, ka pranuar që në këtë iniciativë të ministrit Gent Cakaj të jetë pjesëmarrëse.

**"Epoka e re":** Cili është kontributi i ministrit të Jashtëm të Shqipërisë, Gent Cakaj, në këtë drejtim?

**Kamberi:** Do ta kisha përkufizuar si një mediator i interesuar dhe i përkushtuar që t'i grumbullojë partitë shqiptare nën një ombrellë të përfaqësimit politik të shqiptarëve për t'u fuqizuar kundrejt autoriteteve në Beograd.

**"Epoka e re":** Çfarë ndikimi do të ketë kjo tek elektorati shqiptar? Prisni të rritet dalja e shqiptarëve në zgjedhjet të cilat do të mbahen në pranverë të këtij viti?

**Kamberi:** E thashë se edhe kur kemi garuar në këto zgjedhje si parti e vetme ne kemi arritur të sigurojmë një mandat në parlament, përkundër pragut relativisht të lartë që kërkohet, prej 11 mijë deri në 15 mijë vota, prandaj kur në këtë iniciativë kemi katër parti politike të

grumbulluar nën një ide, besoj se dy mandate do të sigurohen, duke pasur para sysh edhe faktin se në të njëjtën datë në Bujanoc do t'i kemi edhe zgjedhjet lokale të cilat do ta rrisin daljen e elektoratit në zgjedhje.

**"Epoka e re":** Cilat janë pritjet e juaja nga kjo listë e përbashkët. Sa deputetë shqiptarë priten t'i kenë në parlamentin e Serbisë?

**Kamberi:** Reale është t'i kemi dy mandate, megjithatë ne duhet të synojmë edhe më shumë.

**"Epoka e re":** Me rritjen e numrit të deputetëve shqiptarë në parlamentin serb, sa do të bëhen faktorë ata për formimin e qeverisë së re?

**Kamberi:** Nëse kemi para sysh përvojën e deritashme, nuk mund ta kemi pritjen reale që partitë qendrore të tregojnë dëshirë të madhe për të pasur partitë shqiptare brenda një shumice qeveritare. Kjo edhe për shkak të një klime antishqiptare që, me dekada, po mbretëron në Serbi. Prandaj, nisur nga ky fakt, synimi ynë me pjesëmarrje në këto zgjedhje, në rend të parë, ka të bëjë me fuqizimin politik të shqiptarëve dhe me mundësinë më të madhe të sensibilizimit të bashkësisë ndërkombëtare me situatën reale në Luginë të Preshevës, me mundësinë e përdorimit të të gjitha mekanizmave institucionalë për përmirësimin e jetës reale në këtë rajon.

## Engel i përgjigjet admiralit Foggo: Rruga e Serbisë e mbyllur derisa s'e njeh Kosovën

PRISHTINË, 19 JANAR - Kongresisti Eliot Engel, kryetar i Komitetit për Çështje të Jashtme i Dhomës së Përfaqësuesve të Shteteve të Bashkuara, i ka shkruar letër komandantit të Forcave Detare të ShBA-së në Evropë, në lidhje me një intervistë që adreson politikën amerikane ndaj Serbisë. Duke cituar një raport të Departamentit Amerikan të Mbrojtjes, Engel shfaq shqetësimin se komentet e fundit të admiralit James Foggo nuk e reflektojnë plotësisht politikën amerikane ndaj Serbisë. "Ndaj të njëjtën shpresë me ju, se Serbia një ditë mund t'i bashkohet NATO-s, por ajo ditë nuk është afër. Dhe, rruga e saj drejt Bashkimit Evropian mbetet e mbyllur derisa nuk e njeh dhe nuk bën paqe me Kosovën. Prandaj, ju bëj thirrje që në komentet e ardhshme për Serbinë, t'i balanconi më me

kujdes deklaratat, në mënyrë që ato t'i shprehin me saktësi shqetësimet e ShBA-së për rrugën e Beogradit dhe për marrëdhëniet e tij alarmuese me Moskën", ka shkruar Engel në letrën drejtuar admiralit Foggo. Engel, në letrën dërguar admiralit Foggo, u bën jehonë gjetjeve të këtij raporti dhe thotë se para se Vuçiqi dhe partia e tij ta merrnin pushtetin, marrëdhëniet dypalëshe ushtarake të Serbisë me Rusinë kanë qenë të vogla. "Diplomatët e Shteteve të Bashkuara për kohë të gjatë kanë shprehur pakënaqësi me gatishmërinë e Beogradit për të anuar kah Lindja dhe Perëndimi. Serbia nuk e ka harmonizuar politikën e saj të jashtme me Bashkimin Evropian, edhe pse këtë e kërkon procesi i saj i anëtarësimit në BE dhe ajo vazhdon të refuzojë një sërë prioritetesh të përbashkëta ShBA-BE", ka deklaruar Engel.



## Haskuka sot mban takim me qytetarë

PRIZREN, 19 JANAR (ER) - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se sot (e hënë) kryetari i kësaj komunë, Mytaher Haskuka, në orën 10:00 do ta mbajë një

takim me qytetarë. Sipas njoftimit të kësaj komune, Haskuka do t'i njoftojë qytetarët me punët që kanë bërë si kryetar komune gjatë vitit

2019. "Të hënë, më 20 janar, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, do të mbajë takim me qytetarë, ku do të njoftojë për punën e

Komunës së Prizrenit gjatë vitit 2019. Ftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Prizrenit që të marrin pjesë në këtë takim", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



## Komuna e Prishtinës hap procedurat e prokurimit për tregun e ri të qytetit

PRISHTINË, 19 JANAR (ER) - Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se pas rrugës "Model" ka hapur procedurat e prokurimit për projektin e Tregut të ri të Qytetit. Kjo komunë ka njoftuar se ky treg do të jetë pjesë integrale e zonës

historike të kryeqytetit. Komuna e drejtuar nga Shpend Ahmeti ka njoftuar se procedurat e prokurimit për këtë treg do të jenë të hapura deri më 10 shkurt. "Pas rrugës 'Model', procedurat e prokurimit janë hapur edhe për projektin e

Tregut të Ri të Qytetit, që do të jetë pjesë integrale e zonës historike të Prishtinës. Procedurat janë të hapura deri më 10 shkurt dhe, pas afatit të ankesave, ky projekt do të fillojë të implementohet", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.

## Fshati Zasellë i Mitrovicës bëhet me ujësjellës

Mitrovicë, 19 janar (ER) - Në fshatin Zasellë të Mitrovicës është inauguruar të dielën ujësjellësi i ri, projekt ky që ka qenë shumë i nevojshëm për banorët e këtij fshati, të cilët më parë përballeshin me mungesë të madhe të ujit. Në ceremoninë inauguruese që është zhvilluar në oborrin e shkollës së këtij fshati ka marrë pjesë kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri dhe mysafirë të tjerë

të qeverisjes lokale. "Unë prapë do të vazhdoj të investoj me të gjitha mundësitë buxhetore të cilat i kam në dispozicion, në mënyrë që rajoni i Shalës, por edhe të gjitha lagjet dhe fshatrat e tjera të Mitrovicës t'u krijohen kushte sa më të mira për jetesë", ka thënë Bahtiri. Projekti për ndërtimin e këtij ujësjellësi ka nisur në vitin 2015 dhe ka kushtuar rreth 200 mijë euro.



## Koordinatori Hoti shpërndan libra për nxënësit e Skenderajt

SKENDERAJ, 19 JANAR (ER) - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, ka dhuruar pako me libra për nxënësit fitues të Komunës së Skenderajt. Pakot me libra janë shpërndarë për të gjithë nxënësit fitues në Garat e Mendimit Kritik dhe Kreativitetit Kulturor si dhe në Garat Nacionale të Diturisë, të organizuara në nivel shkolle, komune



dhe shteti. Ceremoninë e ndarjes së pakove me libra për fituesit e ka hapur drejtori i Arsimit, Bekim Latifi, i cili në emër të kryetarit të Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, e ka falënderuar koordinatorin Hoti për këto dhurata stimuluese për nxënësit fitues të kësaj komune. Më tutje, Latifi ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim të vazhdueshëm me këtë institu-

cion shtetëror edhe në të ardhmen, me qëllim të interesit të sigurimit të cilësisë së arsimit për nxënësit e Komunës së Skenderajt. Me këtë rast, edhe koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, pasi ka uruar nxënësit e Komunës së Skenderajt për sukseset e arritura, ka theksuar se nxënësit po shpërblehen me këta libra pasi përmes leximit kanë mundësi të arrijnë gjërat më të bukura në jetë.

## Gjilani nis aksionin për lirimin e hapësirave private dhe publike

Gjilani, 19 janar (ER) - Drejtoria e Inspeksionit në Gjilani ka nisur aksionin për lirimin e hapësirave private dhe publike të Shtëpia e Mallrave. Drejtori i Inspeksionit, Nevzad Rushiti, ka njoftuar se ky aksion

ka nisur të premtën dhe do të vazhdojë deri në largimin e konstruksioneve të metalta, të cilat janë shfrytëzuar si terasa verore pa vendime e pëlqime. "Po i lirojmë hapësirat private dhe publike në bazë të peti-

cionit të nënshkruar nga shumica e pronarëve të Shtëpia e Mallrave. Po lirohen hapësirat jashtë objektit të cilat janë shfrytëzuar si terasa verore, pa vendim e pëlqim nga drejtoritë përkatëse. Të gjithë ata që nuk

kanë leje dhe e tejkalojnë hapësirën jashtë objektit, konstruktet metalike do të largohen", ka thënë Rushiti. Ai ka theksuar se Shtëpia e Mallrave po rikthehet në gjendjen e mëparshme.



Presidenti Hashim Thaçi ka pritur të dielën në takim ambasadorin William Walker, ish-shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë

## Ambasadori Walker ia tregoi tërë botës të vërtetën për krimet e Serbisë

Ambasadori William Walker dhe presidenti Hashim Thaçi gjatë një takimi të përbashkët të dielën kanë evokuar kujtime nga periudha e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Thaçi ka thënë se heroi i të vërtetës për krimet serbe në Kosovë, ambasadori Walker, e ngriti krimin në Reçak në rang të ndërgjegjes botërore. Presidenti ka pohuar se pas Reçakut diplomacia botërore u angazhua maksimalisht deri në intervenimin ushtarak të NATO-s mbi caqet policore dhe ushtarake serbe

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 JANAR - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka pritur të dielën në takim ambasadorin William Walker, ish-shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë. Presidenti Thaçi ka thënë se është gjithmonë mirënjohës deri në përlulesi për fjalët emblematike dhe monumentale të ambasadorit Walker për të vërtetën që ia ka prezantuar botës, për masakrën e Reçakut dhe gjenocidin që e ka kryer Serbia në Kosovë. "Ne kemi pasur fatin edhe gjatë luftës të punojmë bashkërisht për tejkalimin e situatave të rënda çfarë kanë qenë dhe unë ndihem mirë që bashkëluftëtarët e mi e kanë mbajtur fjalën në raport me bashkëpunimin me ambasadorin Walker dhe gjithë ndërkombëtarët edhe në atë periudhë kohore. Natyrisht, ambasadori Walker nganjëherë është edhe kritik ndaj nesh që jemi në politikë, por gjithmonë këto kritika kanë qenë tepër të mirëseardhura për t'u përmirësuar. Edhe kur na ka kritikuar e

kemi dashur, e kemi respektuar dhe e vlerësojmë lart punën dhe angazhimin e ambasadorit Walker për shtetin e Kosovës, për popullin e Kosovës, sepse dëshiron ta shohë Kosovën më mirë të konsoliduar. Unë besoj se në kuadër të kësaj edhe interesimi i ambasadorit Walker për ndërtimin e institucioneve të reja, qeverisë së re, është shumë legjitim, shumë i drejtë, sikurse edhe pretendimi ynë që të lëvizim më shpejt përpara", u shpreh presidenti Thaçi. Ai ka theksuar se ardhjet e shpeshta të ambasadorit Walker dëshmon një përkushtimin, dashurinë dhe respektin e tij për Kosovën dhe popullin tonë.

Në anën tjetër, ambasadori William Walker e falënderoi presidentin Thaçi dhe theksoi se vjen në Kosovë sa më shpesh që mundet dhe është shumë krenar për të gjitha ato që janë arritur për 20 vjet. "Kritikoj për gjërat që mund të ishin bërë më mirë, por jam shumë krenar me atë se çfarë është Republika e Kosovës sot, posaçërisht në krahasim me atë se çfarë ishte 21 vjet më parë. Sot vizitova presi-

dentin. Dje isha në Krushë dhe kisha dëgjuar se çfarë ka ndodhur atje, po aq e ndoshta edhe më keq se në Reçak. Po vazhdoj të mësoj gjëra për Kosovën. Kjo është një nga arsyet pse vij këtu.

Unë, po ashtu, vij këtu për të mësuar se çfarë po ndodh politikisht dhe ju jeni momentalisht në mes të një kohe politikisht interesante. Mendoj se Kosova ka nevojë për qeveri. Ju i keni

humbur 100 ditë. Sot është dita e 101-të apo 102-të dhe shpresoj se nuk do të marrë edhe shumë kohë për t'u formuar qeveria", u shpreh ambasadori Walker.

## Operacion i rrallë kryhet në Kirurgji Vaskulare



F. DËRMAKU

PRISHTINË, 19 JANAR - Kirurgët e Klinikës së Kirurgjisë Vaskulare të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), në bashkëpunim me anesteziologët e Klinikës së Anestezionit, kanë realizuar me sukses një ndërhyrje komplekse kirurgjike për të trajtuar një zgjerimin enorm (aneurizëm) të arteries karotide të brendshme në qafë. Sipas një njoftimi të QKUK-së, sëmundja është shumë e rrallë,

sipas evidencës në librat e Klinikës së Kirurgjisë Vaskulare, kjo është ndërhyrja e parë e këtij lloji e realizuar në Kosovë. "Nëse nuk trajtohet aneurizma e arteries karotide të brendshme në qafë është e shoqëruar me një rrezik të lartë për sulm në tru, ndërsa e riptuar me një rrezik të lartë për vdekje. Pacientes 71-vjeçare, e cila është ankuar për një të ënjtur në anën e majtë të qafës, ndjenjë të shtypjes, pengesa në përbirje dhe ka treguar për një sulm iskemik të kaluar në tru, i është larguar zgjerimi aneuriz-

matik, ndërsa arteria është riparuar me lidhje të drejtpërdrejtë", është bërë me dije në njoftimin e QKUK-së. Pacientja ka qëndruar një natë në Njësinë e Mjekimit Intensiv, ndërsa në ditën e pestë pas operacionit është liruar nga spitali. Kjo ndërhyrje ka konfirmuar edhe një herë kompetencën e lartë të stafit të Klinikës së Kirurgjisë Vaskulare për t'u marrë me problemet e arterieve karotide, ndryshimet në të cilat janë një prej shkaqeve më të shpeshta të sulmit në tru.



Vizitë në familjen e Jahir Morinës në Bainsë të Istogut

# Familja nga Istogu jeton në varfëri të skajshme, kërkon ndihmën e qytetarëve

Familja shtatanëtarëshe e Jahir Morinës nga Baica e Istogut jeton në kushte skajshmërisht të rënda ekonomike dhe sociale. Në kohën kur temperaturat shënojnë në minus gradë celsius, kësaj familjeje, pos ushqimit, veshmbathjeve dhe gjërave higjienike, i mungojnë edhe drunjtë e zjarrit. Shtëpia e saj kundërmon në të katër anët, pasi çdo pikë shiu depërton në muret dhe shtretërit e shtëpisë. Kurse ndihma sociale prej 125 eurosh nuk i mjafton për t'i ushqyer dhe veshmbathur pesë fëmijët, tregon për gazetën "Epoka e re" bashkëshortja e Jahir Morinës, Drita



**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**ISTOG, 19 JANAR** - Familja shtatanëtarëshe e Jahir Morinës nga Baica e Istogut jeton në kushte skajshmërisht të rënda ekonomike dhe sociale. Si pasojë e kushteve të rënda ekonomike kësaj familje i mungojnë mallrat e konsumit elementar për jetë, që ka ndikuar që fëmijët e kësaj familje të asocializohen nga shkollimi dhe nga rrethi, pasi që vajza shtatëvjeçare e kësaj familjeje, si pasojë e mungesës në të folur, nuk e ka vazhduar mësimin parashkollor, kurse djali trevjeçar mund t'i shqiptojë vetëm fjalët mami dhe babi.

Në kohën kur temperaturat shënojnë në minus gradë cel-

sus, kësaj familjeje, pos ushqimit, veshmbathjeve dhe gjërave higjienike, edhe drunjtë e zjarrit i mungojnë. "Nuk do të kemi më dru për dimër, pos këtyre që i shihni. Fëmijët kanë të ftohtë dhe s'kanë as çorapë e as veshmbathje. Nuk e di si do ta kalojmë këtë dimër", ka thënë nëna e pesë fëmijëve, Drita Morina.

Shtëpia e tyre kundërmon në të katër anët, pasi çdo pikë shiu depërton në muret dhe shtretërit e shtëpisë. Kurse ndihma sociale prej 125 eurosh



nuk u mjafton për t'i ushqyer dhe veshmbathur pesë fëmijët e kësaj familje, pasi një pjesë të kësaj shume kryefamiljari Morina e ka borxh, të cilin e mori për blerjen e katër dritareve të shtëpisë në të cilën

jeton tash e 17 vjet.

Zonja e kësaj shtëpie, Drita Morina, ka treguar për gazetën "Epoka e re" se kushtet e rënda në të cilat jeton bashkëshorti i saj, Jahiri, i cili është i moshës 73-vjeçare dhe pesë fëmijët e tyre, janë të papërbalueshme dhe ngulfatëse për jetë. Ajo ka thënë se është e lodhur nga varfëria e skajshme dhe i është mërziur jeta, pasi s'mund t'u përgjigjet fëmijëve kur ata i kërkojnë bukë. Madje në ditën që e vizitua ajo s'kishte as maj për bukë, as miell, as krip. "As nuk kam dru, as bukë e as krip që t'u përgatis fëmijëve bukë. Sot fëmijët kanë qarë gjithë ditën pasi s'pata maj për t'u përgatitur bukë", ka rrëfyer nëna e pesë fëmijëve Drita Morina.

Ajo ka deklaruar se si pasojë e kushteve të rënda ekonomike fëmijët e saj janë të asocializuar dhe kanë pengesa në të folur, gjë që, sipas saj, vajza e tyre shtatëvjeçare Ernesa bëri që të largohet edhe nga mësimi parashkollor. "Si pasojë e kushteve të rënda ekonomike dhe mosmundësisë që t'i ushqejmë me bukë fëmijët janë

të nervozuar dhe ka raste kur s'mund as të flasim. Fëmijët kanë pengesë edhe në të folur. Vajzën më është dashur ta ndalojmë nga cikli parashkollor pasi s'flet mirë dhe ne duhet ta dërgojmë për kontroll, por kushtet nuk i kemi që të shkojmë pas mjekëve. Një qytetar që rastësisht e takuam një ditë dhe ia treguam gjendjen e vajzës, na i fali do para dhe e dërguam vajzën te një mjek në Prishtinë. Për t'u përmirësuar gjendja e saj duhen kontrole të vazhdueshme. Por, ne nuk kemi para që të vazhdojmë më tutje", ka thënë ajo.

Familja shtatanëtarëshe e cila merr asistencën sociale në shumën prej 125 eurosh dhe pensionin e pleqërisë të kryefamiljarit, pjesën më të madhe e ka borxh, pasi për t'u mbrojtur nga i ftohti i këtij janari, ata kishin vendosur që t'i blinin katër dritare të shtëpisë, në të cilën jetojnë në kushte të rënda tash e 17 vjet. "Ne marrim ndihmën sociale dhe pensionin e burrit, por e kemi borxh pasi na është dashur t'i blejmë disa dritare për shtëpi. Fëmijët janë të vegjël dhe vazhdimisht kol-



litën nga i ftohti. Këtu në këtë shtëpi askush s'do të mund ta kalonte një natë nga i ftohti dhe era që kundërmon, pasi shiu pikë edhe mbi trupin tonë. Nuk më ka mbetur gjë tjetër pos ta mbys veten dhe mos t'i shoh më fëmijët duke vuajtur për bukën e gojës", ka thënë ajo, duke shtuar se djali i madh është larguar nga skema pensionale pasi nuk ka pasur mundësinë që ta nxjerrë një vërtetim të shkollës. "Pension i marrim 125 euro dhe i kam pesë fëmijë. Djali i madh është

janë hequr 10 euro nga social. Fëmijët janë të moshës 7, 4, 3 tre vjeç dhe fëmija i vogël është katërmuajsh, i cili më shumë rrinë duke qarë pasi s'kam kushte t'ia blej qumështin që është për fëmijë. Një ditë e pata te mjeku dhe i kërkova një zotërisë që të m'i japë do pare për sadaka, ai m'i dha 10 euro dhe me ato para i bleva qumësht, por sot është harxhuar dhe s'di çfarë do të bëj më tutje", ka thënë Drita Morina. Nëna e pesë fëmijëve, Drita Morina, ka apeluar te të gjithë qytetarët që kanë mundësi t'i ndihmojnë me ushqim dhe veshje. "I kisha lutur të gjithë ata që kanë mundësi të na ndihmojnë pasi fëmijët i kam të vegjël dhe s'kam nga t'ia mbaj. Burri është i moshuar dhe i sëmurë dhe s'ka mundësi të punojë. Jetën që në bëjmë mos e bëftë askush!", ka thënë Morina. Të gjithë ata që mund ta ndihmojnë familjen Morina, vendbanimi i saj është në fshatin Baicë të Istogut, magjistralia Istog - Pejë, kthesa e parë në të djathë në hyrje të fshatit. Gjithashtu, këtë familje mund



larguar nga skema pensionale pasi s'kam pas kushte ta nxjerr një vërtetim të shkollës dhe na

ta kontaktoni edhe në këtë numër të telefonit +38349299685.

# Shumica e bizneseve ende pa arka fiskale

Drejtori përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, thotë se në shifrën e përgjithshme të bizneseve të regjistruara ende figurojnë edhe bizneset e shuara. Në bazë të të dhënave të ATK-së, Murtezaj thotë se ekzistojnë mbi 88 mijë tatimpagues. Në kuadër të kësaj shifre llogariten edhe mbi 30 mijë persona fizikë



PRISHTINË, 19 JANAR - Shumica e bizneseve që operojnë në tregun e Kosovës ende nuk i janë përgjigjur thirrjes së institucioneve kompetente për t'u pajisur me arka fiskale. Edhe pse ky proces ka filluar para një dekade, sipas të dhënave zyrtare, rezulton se as gjysma e tyre nuk janë fiskalizuar.

Në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, konkretisht në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, janë të regjistruara rreth 200 mijë biznese. Deri më tash procesin e fiskalizimit e kanë përfunduar rreth 33 mijë biznese me mbi 42 mijë pajisje elektronike fiskale.

Pajisja me arka fiskale të subjekteve afariste kishte filluar si proces në vitin 2010 dhe qëllimi ishte evitimi i evazionit fiskal, pasi potenciali i këtij sistemi është që t'i regjistrojë të gjitha hyrjet dhe daljet (shitjet).

Drejtori përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, thotë se në shifrën e përgjithshme të bizneseve të regjistruara ende figurojnë edhe bizneset e shuara. Në bazë të të dhënave të ATK-së, Murtezaj thotë se ekzistojnë mbi 88 mijë tatimpagues. Në kuadër të kësaj shifre llogariten edhe mbi 30

mijë persona fizikë. Ai thotë se procesi i fiskalizimit do të jetë prioritet i Administratës Tatimore për vitin 2020, në mënyrë që të ketë trajtim të barabartë për të gjitha bizneset. "Ky numër rreth 33 mijë tatimpagues të fiskalizuar janë pjesa dërrmuese e bizneseve të mesme dhe të mëdha, kurse pjesa tjetër që ka mbetur pa u fiskalizuar janë biznese të kategorisë së vogël. Mirëpo, si do që të jetë, do ta zbatojmë në tërësi ligjin dhe do t'i detyrojmë të gjithë ata që janë të obliguar të fiskalizohen, sepse ka edhe tatimpagues të tillë që ligji nuk i obligon të fiskalizohen, nëse nuk përdorin para të gatshme", ka thënë Murtezaj.

Edhe zyrtarë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë konfirmojnë se bizneset e shuara nuk largohen nga regjistri i bizneseve.

Bajram Shala, zëdhënës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se numri i përgjithshëm i bizneseve të shuara është mbi 25 mijë. Nga ky numër, vetëm vitin e kaluar veprimtarinë e tyre biznesore e kanë ndaluar rreth 1 800 biznese.

Ekspertë për çështje ekonomike

konsiderojnë se mospërdorimi i arkave fiskale ndikon në rritjen e ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal.

Lekë Musa, ekspert për çështje ekonomike, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" ka pohuar se mungesa e këtyre pajisjeve reflekton në mungesën e transparencës financiare dhe, njëherësh, krijon konkurrencë jo të drejtë në tregun e Kosovës. "Ky problem është multidimensional, nuk ka të bëjë vetëm me pajisje me arka fiskale, por ka të bëjë me çështjen e raportimit të drejtë të bizneseve për të hyrat dhe qarkullimin e tyre, që më pas duhet të ndërlihet me pagesat e tatimit përkatës që iu takon bizneseve", është shprehur Musa.

Në raportet vendore dhe ndërkombëtare në vazhdimësi theksohet se ekonomia jologjore në Kosovë përbën më shumë se 30 për qind të bruto produktit vendor që, përkthyer në shifra, është rreth 1.8 miliard euro në vit. Në rast të mosinstalimit të pajisjeve elektronike fiskale, sipas Ligjit për Administratën Tatimore të Kosovës, çdo person i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ prej një mijë eurosh për çdo shkelje të tillë.



# SHTIGJET E PËRFLAKURA TË JANARËVE TË LIRISË

Mehmet HAJRIZI

1 Lëvizja Kombëtare Shqiptare me historinë e saj të gjatë sa vetë sundimi dhe robëria e popullit që përfaqësonte përbën përvojë të pasur, të pastër e të lavdishme çlirimtare. Organizimi i studiuar dhe profesional i saj, përpjekjet titanike dhe gjaku i derdhur rrëke në emër të idealeve të larta, në emër të së drejtës e të lirisë, të barazisë e demokracisë, e kanë bërë Lëvizjen tonë çlirimtare njërin nga shembujt universal të luftës për një botë më të drejtë, më të lirë dhe më humane.

Rezistenca dhe qëndresa triumfuese e popullit shqiptar kundër robërisë dhe pushtimit të huaj, historia e lavdishme e tij, i mban përjetë krenarë brezat e pambarim të racës shqiptare.

Në historinë më të re të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, përfaqësues emblemikë të saj, sipas shembujve heroikë të traditës luftarake të paraardhësve, e vunë veten në shërbim dhe përkushtim të plotë për liri, deri në sakrificën supreme. Në këtë vazhdë, në janarët e përflakur të viteve 1982 dhe 1984 ranë për të mos vdekur kurrë edhe heronjtë Kadri Zeka, vëllezërit Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Rexhep Malaj e Nuhi Berisha.

2 Kryengritja e vitit 1981 kishte shpërthyer si pasojë e statusit prej kolonie të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi, në njërin anë dhe si rezultat i veprimtarisë së gjatë e të bujshme të Lëvizjes Kombëtare shqiptare, në anën tjetër. Regjimi pushtues dhe zëdhënësit e tij në Kosovë proklamuan me eufori se nga viti 1974, kur Kosova ishte avancuar në element konstituiv i Federatës Jugosllave, shqiptarët gjoja ishin barazuar me popujt e tjerë në Jugosllavi. Por e vërteta ishte që ata vazhdonin të mbeteshin popull i diskriminuar, i shtypur dhe i shfrytëzuar egërsisht. Jens Reuter, në librin "Shqiptarët në Jugosllavi", duke shkruar për Krahinën e Kosovës, si strehë e të varfërve e Jugosllavisë, thotë: "Më 1947 mesatarja jugosllave e zhvillimit ishte dy herë më e lartë se ajo e Kosovës, kurse më 1980 ky raport ishte katër me një".

Kryengritja e vitit 1981 përbën njërin dhe rubikonin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare nën Jugosllavi. Ndonëse u shua në gjakun e dëshmorëve të saj dhe të rreth një mijë të plagosurve me armë zjarri, ndonëse e pati edhe çmimin e dhjetëra mijë të dënuarve e mbi shtatëqind mijë të trajtuarve në polici, ajo shënoi rezultate dhe fitore historike.

Çështja shqiptare jo vetëm u bë e njohur gjithandej në botë, duke siguruar solidaritet të gjerë, por



mund të thuhet se edhe u shtrua si një problem që kërkonte zgjidhje. Mediat botërore i bënë jehonë të gjerë kryengritjes, kurse diplomacia dhe politika ndërkombëtare, që nga Parlamenti i Bashkimit Evropian dhe deri në Kongresin Amerikan, filluan ta trajtojnë çështjen shqiptare, si një problem të pazgjidhur. Në një botim të veçantë të asaj kohe, propaganda e Beogradit me të drejtë konstatonte se ngjarjet e muajve të fundit në Kosovë hyjnë në zhvillimet më dramatike në historinë më të re të Jugosllavisë.

Kryengritja e vitit 1981 ndikoi vullshëm për zgjimin shqiptar shënoi fillimin e fundit të sundimit serb në Kosovë, hapi një horizont të ri të zhvillimit të Lëvizjes Kombëtare dhe për herë të parë, lëkundti seriozisht themelet e Jugosllavisë së AVNOJ-it. Ajo e lëvizi dhe e ndryshoi historinë shkroi me gjakun e dëshmorëve dhe shprehu vullnetin politik në mënyrë plebishitare të popullit të robëruar shqiptar, vrau frikën dhe shpërfaqti vërtetet e larta të sistemit të vlerave tradicionale e luftarake shqiptare.

3 Kjo kryengritje, si revoltë e organizuar qytetare e kishte parathënien, por edhe pasthënien e vet. Lëvizja Kombëtare e viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar, pas demonstratave të njohura të '68-s, për dhjetë vjet rresht kishte vepruar për organizimin, konsolidimin dhe fuqizimin e radhëve të veta, duke formuar militantë profesionistë të përgatitur për staza të gjata të shtegtitimit revolucionar. Në themel të këtyre përpjekjeve, që në moshë të re, u angazhuan heronjtë e ardhshëm Rexhep Malaj dhe Kadri Zeka me të cilët më vonë u

bashkuan edhe Jusuf Gërvalla, Nuhi Berisha dhe Bardhosh Gërvalla. Ndonëse në organizata dhe në periudha të ndryshme, ata i bashkonte një ideal, një qëllim dhe sakrificë në emër të tij.

Lëvizja Kombëtare e viteve shtatëdhjetë kishte arritur pjekuri të lartë politike, formim teorik dhe intelektual të veprimtarëve dhe zbatonte norma të rrepta organizative, si disiplina dhe konspiracioni. Megjithatë, intensifikimi i veprimtarisë për zgjerimin e radhëve, për shtypin e larmishëm klandestin dhe shpërndarjen e tij, për shtrirjen e strukturave të organizuara në gjithë gjeografinë shqiptare të pushtuar nga Jugosllavia, por edhe në mërgatë, për aksionet praktike në terren dhe demaskimin e politikës pushtuese, për përgatitjen e kushteve të një rezistence të hapur qytetare etj., bënte që rrjeti i dendur agjenturor të gjente fije dhe pista dyshimi për veprimtarët e lirisë. Korifenjtë tanë të Lëvizjes kishin rënë në sy të UDB-së famëkeqe, prandaj Rexhep Malaj e dënuan me shumë vite burg, ku në pranga e vazhdoi veprimtarinë, kurse Kadriu, Jusufi, Nuhiu dhe Bardhoshi u detyruan të vepronin në konspiracion të thellë ose të mërgonin jashtë vendit.

4 Gjatë dhe pas kryengritjes së vitit 1981 Lëvizja Kombëtare u godit rëndë, por ajo nuk mund të zhdukej më, prandaj si feniksi filloi ripërtëritjen. Në rendin e ditës të historisë ishte bashkimi i potencialit të përndarë në disa organizata të kësaj Lëvizjeje, në një front të përbashkët dhe të vetëm. Përpjekjet e para ishin bërë para kryengritjes, por rezultatet u bënë të dukshme pas saj, sidomos në

mërgatë, ku Kadri Zeka dhe Jusuf Gërvalla i shkruan strukturat e tyre organizative, jo në tavolinë por në veprim, në demonstratat e fuqishme për mbështetjen e kërkesave të atyre brenda vendit për barazi dhe Republikë.

I ndodhur në një gjendje pamundësie, paqartësie, hutimi dhe konfuzioni, regjimi pushtues serb e jugosllav u ndje i rrezikuar para këtij uragani rezistues popullor, por edhe nga solidarizimi i gjerë ndërkombëtar me kërkesat legjitime shqiptare, prandaj hapi frontin e gjerë antishqiptar në përgjithësi dhe kundër Lëvizjes Kombëtare në veçanti. Atij nuk i mjaftuan vrasjet dhe represaliet gjatë kryengritjes, burgosjet masive etj., por u detyrua të organizojë edhe atentate tinëzare kundër përfaqësuesve të lartë të Lëvizjes Kombëtare. Për ta parandaluar procesin e bashkimit të organizatave atdhetare, policia e fshehtë jugosllave vrau në pritë kriminale, në krye të detyrës së bashkimit, Kadri Zekën, Jusuf e Bardhosh Gërvallën në Untergruppenbach të Gjermanisë, në 17 janarin e acartë të vitit 1982. Kjo vrasje jo vetëm nuk e dërrmoi Lëvizjen, siç pretendohet, por ngriti në këmbë mijëra të tjerë për ta shpëtuar dhe fuqizuar atë për shtigje të reja të lirisë. Po atë vit bashkimi u arrit për të qenë aktiv deri në luftën çlirimtare dhe ngadhënjimin e saj mbi armikun pushtues.

5 Parulla e bashkimit, e thirrur aq shumë në Kryengritjen e vitit 1981, vazhdonte të jehonte edhe pas tri viteve, kur ndihej nevoja e shkrires së shumë organizmave çlirimtare të formuara para dhe sidomos pas demonstratave. Rexhep Malaj, tashmë i kthyer nga burgu, bashkë me veprimtarin e hershëm Nuhi Berisha u vunë në ballë të përpjekjeve në procesin përbashkues të potencialit të rezistencës brenda dhe jashtë. Të ndjekur nga regjimi, ata vepronin në konspiracion të thellë dhe në kushte tepër të rënda të represionit e terrorit udhësk. Dy vjet pas krimit në Gjermani, forca të mëdha policore të njëjësve speciale vranë edhe Rexhep Malajin e Nuhin Berishën, më 11 janar 1984. Edhe ky krim po bëhej në funksion të parandalimit të bashkimit dhe të mposhtjes së Lëvizjes, por efekti i tij qe krejt i kundërt. Sikundër Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që mori hov dhe masivizim pas rënies së komandantit legjendar Adem Jashari dhe të familjes së tij në mars të vitit 1998 në Prekaz, kështu edhe pas çdo vrasjeje tjetër të veprimtarëve, para dhe pas saj, kishte ngritur mijëra të rinj për t'i zëvendësuar të rënë.

6 Humbja e këtyre personaliteteve të shquara të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të përgatitur gjatë si

veprimtarë profesionistë dhe me rolin prijës në kohë kthesash me rreziqe të paparashikueshme, nuk mund të kompensohej shpejt as lehtë.

Ata dinin të kapnin fillin zhvillimor të Lëvizjes, duke trajtuar çështje jetike të saj, si bashkimi dhe zgjerimi i radhëve të organizuara, ndërtimi strukturor i qëndrueshëm i tyre, disiplina dhe konspiracioni i veprimit, afirmimi ndërkombëtar i çështjes së pazgjidhur shqiptare dhe edukimi patriotik e formimi i militantëve të organizuar.

Jusuf Gërvalla e Kadri Zeka më 1982 dhe dy vjet më vonë, Rexhep Malaj e Nuhi Berisha ishin dhe mbetën shembull i shkëlqyer dhe monumental në historinë e përpjekjeve të figurave të shquara të kombit tonë për bashkimin e mendjes e të forcës, të potencialit shqiptar të lirisë.

Heronjtë tanë përfaqësonin vërtetet sublime si, dija dhe guximi, vullneti i hekurt dhe vendosmëria, dashuria ndaj atdheut dhe vetëmohimi, lidërshipi dhe shkathhtësia, kujdesi për bashkëveprimtarët dhe solidariteti, shpirti njerëzor e modest i tyre. Ata edukuan breza të Lëvizjes Kombëtare dhe mbetën përgjithmonë shkollë e edukimit të atdhedashurisë, burim i pashtershëm i frymëzimit të të gjithë brezave.

Në jetë njeriu mund ta zgjedhë rrugën e lehtë, të interesave mesquine, të ambicieve protagoniste e të famës personale, por dëshmorët zgjedhën rrugën e drejtë e të vështirë, të interesit të përgjithshëm e të sakrificës, prandaj fama u shkon pas si hija. Duke u flijuar "në ballë të popullit dhe te këmbët e tij", ndryshe nga ne të gjallët e përkohshëm ata u bënë përjetshëm të gjallë.

Kombi ynë i vogël ka shumë dëshmorë, të cilët si dikur edhe sot e gjithmonë do të përbëjnë atë bankën kombëtare të vlerave njerëzore e virtyteve të larta fisnike, nga e cila marrim kredi të gjithë. Ata janë faktet e historisë sonë, janë mburja dhe krenaria shqiptare. Ta mbash gjallë kujtimin për dëshmorët, do të thotë të mbash gjallë kombin, sepse kur shuhet kujtimi për dëshmorët, vdes edhe kombi i tyre.

Në këto çaste emocionante, të pushtuar nga ndjenja dhembjeje e krenarie, dashurie e malli, nderimi e obligimi atdhetar, i falemi kujtimin të emrit, jetës dhe veprës së dëshmorëve të pavdekshëm.

I ndodhur në këto treva shqiptare, dua të vlerësoj lart dhe ta shpreh mirënjohjen e thellë për kontributin e madh dhe dëshmorët e shumë të që i kanë dhënë ato çështjes së shenjtë të kombit dhe lirisë e përparimit të tij.

I përjetshëm do të jetë kujtimi për dëshmorët e kombit.

(Fjalë e mbajtur në manifestimin "Flaka e Janarit" në Gostivar dhe Kërçovë, më 16-17 janar 2020)

Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (5)

# Dipolet magnetike



**Shkruan: Naim  
KRASNIQI, fizikan**

## Argument

Tani supozojmë se në vend të dy sferave magnetike ( $m_1$ ) dhe ( $m_2$ ) marrim dy dipole magnetike ( $dm_1$ ) dhe ( $dm_2$ ), që gjenden afër poleve magnetike, që të dyja njëkohësisht do të tërhiqen nga polet magnetike (N) dhe (S) dhe do të lëvizin në drejtime të kundërta drejt qendrës së magnetit, edhe ku do të mbesin.

1. Si është e mundur që dy dipolet magnetike ( $dm_1$ ) dhe ( $dm_2$ ) tërhiqen njëkohësisht nga të dy polet magnetike, kurse fizika e thotë se dipolet magnetike burojnë nga poli magnetik i veriut (N). 2. Si është e mundur që këto dipole magnetike lëvizin në drejtime të kundërta, dhe ndalojnë në mesin e magnetit, përderisa fizika e tregon se dipolet magnetike hyjnë në polin magnetik të jugut (S) dhe dalin nga poli magnetik i veriut (N) dhe ky fenomen përsëritet tërë kohën.

3. Nëse dy sferat magnetike nevojitet një forcë (F) për t'i nxjerrë nga brendia e magnetit cilindrik, në drejtim të poleve magnetike (N), atëherë cila është ajo forcë që e detyron dipolet magnetike ( $dm_1$ ) dhe ( $dm_2$ ) të lëvizin nga mesi i magnetit në drejtim të polin magnetik të veriut (N).

Ekspërimentin e dytë dhe të tretë, tregojnë saktë fenomenet se nëse një magneti ia afrojmë dy sfera të magnetizuara, ato përfundojnë në mes të magnetit dhe aty mbesin. Ky është një eksperiment natyral dhe përputhet me ligjet e po kësaj natyre në të cilën jetojmë. Prandaj, natyra e thotë një të vërtetë se nga magnetet nuk buron fushë magnetike e cila buron nga një dipol magnetik i veriut (N) dhe hyn në dipolin e tjetër magnetik (S). Prandaj, në asnjë rrethanë nuk mund të vërtetohet se fusha magnetike buron nga poli magnetik i veriut (N) dhe hynë në polin magnetik të jugut (S). Andaj, kuptimi i fushës magnetike të tanishme nuk ka një bazë bindëse shkencore që e argumenton se fusha magnetike buron nga një pol magnetike dhe shkon drejt polin të tjetër magnetik.

## Ligji i poleve magnetike të një magneti

Asnjë ndryshim nuk ka në mes poleve magnetike të çfarëdo

magnetit, si poli magnetik i veriut (N) ashtu edhe poli magnetik (S) kanë të njëjtën natyrë, dhe kryejnë të njëjtat funksione.

## Anomali e të kuptuarit të fushës magnetike të tokës

Edhe pse eksperimentalisht vërtetohet saktë ky fenomen, asnjëherë nuk është kuptuar se pse gjilpëra magnetike e merr këtë pozitë, shkencërisht mendohet se fusha magnetike është një lëvizje e dipoleve magnetike, të cilat burojnë nga poli magnetik i veriut (N) dhe hyjnë në polin magnetik të jugut (S). Edhe pse thuhet kështu kjo nuk argumentohet, por proceset që zhvillohen në natyrë japin tërësisht rezultate të kundërta. Po të bazohemi në ligjet e fizikës ku bartëse të fushës magnetike janë dipolet magnetike, prandaj në një qastë le të supozojmë se këto dipole magnetike ndodhen të mbyllura me porta mbyllëse brenda poleve të një magnetit. Bazuar në ligjet e fizikës thuhet se sapo portat e magnetit të hapen dipolet magnetike do të orientohen vetëm në drejtim të polin magnetik të veriut (N), nga i cili pol do të dalin dhe do të shpërndahen, e pastaj do të kthehen te poli magnetik i jugut (S).

Ky proces duhet të ndodhë me dipolet magnetike, ato duhet të orientohen dhe të dalin vetëm nga poli magnetik i veriut (N), sepse është në përputhje me ligjet e Fizikës. Ne nuk i shohim dipolet magnetike nga burojnë, prandaj a duhet t'i besojmë apo jo këtij procesi. Besueshmërinë e tyre për ta përforcuar apo kundërshtuar këtë proces fizik, ne duhet prapë t'i drejtohem natyrës, dhe të shohim se ky proces a ndodhë realisht, apo është ndonjë imagjinatë e gabuar. Prandaj, tani për ta përforcuar apo kundërshtuar këto të dhëna shkencore ne do t'i drejtohem eksperimentit të katërt.

## Ekspëriment 4

E marrim një gyp (G) skajet e të cilit janë të mbyllura me dy porta (a) dhe (b). Tani gypin e mbushim me ngjyrë të zezë dhe në gyp e rrisim presionin e caktuar në 5 bar ashtu sikur shihet në figurën 4. c). Gypin e vendosim në çfarëdo pozite që e




Fig. 4c




Fig. 5




Fig. 6

kemi vendosur magnetin cilindrik (M). Nëse njëkohësisht i hapim dy portat (a) dhe (b) të gypit, do të shohim se ngjyra e zezë do të del nga dy anët njëkohësisht.

Prandaj, në të dy anët e gypit kemi një simetri të ngjashme të shpërndarjes së ngjyrës së zezë. Andaj, nga asnjëra anë nuk shihet se ka ndryshime.

Hapja e portave të gypit me ç'rast ngjyra e zezë njëkohësisht buron nga të dy anët e gypit është një ligj i natyrës, dhe natyra nuk vepron ndryshe. Kurse po të krahasohet ky fenomen i natyrës me fushën magnetike nga cila mendohet se buron vetëm nga poli magnetik, japë rezultate të kundërta.

Ne këtu e shohim se nga të dy anët buron ngjyra e zezë, por te fusha magnetike nuk e shohim se nga buron fusha magnetike. Sepse nuk posedojmë një teknologji të tillë për t'i parë qartë se nga burojnë dipolet magnetike. Por siç është theksuar te eksperimenti i parë, fusha magnetike ka një formë simetrike të ngjashme në të dy polet magnetike, ashtu sikur është e ngjashme pamja simetrike e ngjyrave që burojnë

nga skajet e tubit. Ekspërimentin mund të përsëritet shumë here, por gjithëherë kemi rezultate të njëjta, dhe absolutisht është e pamundur por edhe tërësisht e pa logjikshme që ajri të del nga njëra portë qoftë (a) apo (b) të shpërndahet në të gjitha anët dhe prapë e njëjta sasi e ajrit të hynë në portën tjetër. Por ky nuk mund të jetë edhe argumenti i vetmi që e kundërshton një fushë magnetike që do të buronte vetëm nga poli magnetik i veriut (N). Për ta përforcuar apo kundërshtuar vazhdojmë me eksperimentin.

## Ekspëriment 5

E marrim një pompë të ujit dhe e vendosim në një pus të mbushur me ujë. Pompa është e pajisur një motorë elektrik, kurse në të dy skalet kate tuba me seksione të njëjta. Pompa lëshohet në funksion dhe e tërheq ujin nga njëra anë (a), kurse e nxjerrë në anën tjetër (b).

Tubat e ujit janë afër sipërfaqes së ujit dhe mund të vërehen lëvizjet e ujit në të dy anët e pompës.

Ekspërimentalisht do të vërtetohet se do të ndryshon tërësisht forma e ujit në mes anës

(a) ku tërhiqet uji, dhe anës (b) prej nga del uji. Në pjesën dalëse (b) do të krijohen valë të ujit që vijnë duke u zgjeruar nga dalja në drejtim të periferisë ashtu sikur shihet në figurën 5. Por kjo nuk ndodhë në pjesën hyrëse (a) sepse këtu nuk krijohen absolutisht valë sikur në dalje të pjesës (b). Sepse këtu vërehet valë shumë më të vogla te pjesa (a) ku hyn uji. Prandaj, ky eksperiment bazohet gjithashtu në ligjet e natyrës.

Nuk mund të krijohen valë simetrike të ujit në mënyrë natyrale me një pompe e cila e merr ujin nga njëra anë dhe e nxjerrë nga ana e tjetër. Pasi valët e ujit nuk janë simetrike në të dy anët e pompës, ku hyn dhe nxirret uji, si ndodhë që valët e fushës magnetike të jenë simetrike në të dy polet e magnetit, pasi aty mendohet se fusha magnetike buron nga poli magnetik (N) dhe prapë kthehet te poli magnetik i jugut (S) duke krijuar një fushë simetrike.

Procedura e punës është e njëjtë por forma e valëve nuk ndërlidhet askund, duke mos ju larguar eksperimenteve me valë uji tani vazhdojmë me eksperimentin 7.

## Ekspëriment 6

Për dallim nga rasti i mëparshëm, tani do ta marrim një gyp në formë të (T), seksioni i gypit (c) është i barabartë me dy seksionet e gypave (a) dhe (b). Prandaj, gypin (c) është i lidhur me një pompë ujit. Pompa lëshohet në funksion, duke tërheq ujin nga ana e poshtme e pusit të ujit, dhe duke e nxjerrë ujin njëkohësisht nga të dy tubat (a) dhe (b). Prandaj eksperimentalisht do të shohim se valët do të përhapen në të njëjtën mënyrë si nga dalja e gypit (a) ashtu edhe nga dalja e gypit (b). Prandaj valët në të dy anët e gypit janë simetrike me njëra-tjetrën, shih figurën 6.

Prandaj, forma e valëve të ujit në të dy anët e gypave merr një formë simetrike si në pjesën (a) ashtu edhe në pjesën (b). Për dallim nga rasti i mëparshëm në eksperimentin 5, tani në këtë eksperiment 6 kur nga të dy anët e pompës (a) dhe (b) buron uji, formohen valë në formë simetrike dhe tërësisht të ngjashme sikur te fusha magnetike që merr një formë simetrike mbi polet e magnetit.

(VIJON)

# Politika e brendshme dhe e jashtme e Skënderbeut

-Me rastin e 552-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut

## NEXHAT KRASNIQI

Skënderbeu lindi në familjen e Kastriotëve rreth vitit 1405. Ishte djali i Gjonit dhe i Voisllavës. Vëllezërit e Skënderbeut ishin: Stanishi, Reposhi dhe Konstadini. Skënderbeu kishte pesë motra: Marën, Jellën, Angjelinën, Vlajkën dhe Mamicën. Sipas shumë burimeve, Skënderbeu që në moshën nëntëvjeçare u dorëzua si peng në Perandorinë Osmane. Atje u shkollua në kryeqytetin e Perandorisë Osmane, në Edrene. U edukua në shkollën e ico-ogllarëve për 10 vjet dhe tregoi aftësitë e veçanta të artit ushtarak si një strateg i rrallë.

Pas një sërë fushatash ushtarake në kuadër të Perandorisë Osmane, erdhi koha e kthimit në vendlindje, për të kontribuar si udhëheqës shqiptar. Më 28 nëntor 1443 e merr Krujën në mënyrë diplomatike, për ta ngritur shkabën dykrenare në kështjellën e Krujës, me ç'rast ky ishte momenti i fundit kur u largua përgjithmonë nga tabori i Perandorisë Osmane dhe filloi lufta e hapur kundër saj.

Fitoret e para kundrejt Perandorisë Osmane dhe marrja e një sërë kështjellash nga osmanët, (Petrelës afër Tiranës, Gurit të Bardhë në Mat, Stelushit e Sfetingradit në Dibër etj.), e fuqizuan Skënderbeun si një lider të veçantë politiko-ushtarak.

Fitimi i autoritetit si një fitimtar i Skënderbeut ia mundësoi edhe liderizmin para principatave shqiptare pavarësisht prej kundërshtimeve... Skënderbeu e pa të udhës që sa më parë ndërmyet tij dhe kryezotërinjve të ndryshëm shqiptarë të zhvilloheshin një sërë takimesh individuale për marrëveshje, e që si rezultat i angazhimit në këtë drejtim, doli mendimi që të thirret një kuvend... u vendos që Kuvendi të mbahej në Lezhë, e cila atëkohë ishte nën zotërimin e Venedikut, për të mos ngjallur dyshime te bujarët e tjerë shqiptarë në raport me Principatën e Kastriotëve.

Kuvendi i Lezhës i filloi punimet më 2 mars 1444 në katedralen e Shën Kollit në Lezhë. Në të morën pjesë shumë princër e fisnikë shqiptarë, si: Gjergj Arianiti, Andrea Topia, Nikollë e Pal Dukagjini, Teodor Muzakaj, Gjergj Stres-Balsha, Lekë Zaharia, Lekë Dushmani, Pjetër Spani etj.

Skënderbeu mbajti fjalën e hapjes në Kuvend, duke i kushtuar rëndësi bashkimit politikë e ushtarakë të shqiptarëve. Format e bashkëpunimit dhe

rrugët për realizimin e bashkimit politik të tyre në themele vendosen besën. Ata institucionalizuan Kuvendin si formim politik më të lartë vendimmarrës të fisnikëve shqiptarë.

Kuvendi vendosi që bashkimi i shqiptarëve të bëhej në formën e një besëlidhjeje politike ndërmjet drejtuesve të zotërimeve të lira dhe fisnikëve të tjerë të vendit, që u njoh me emrin Besëlidhja Shqiptare e Lezhës. Ajo ishte një aleancë politiko-ushtarake. Kryetar i saj u zgjodh Skënderbeu, kurse institucioni më i lartë vendimmarrës u bë Kuvendi i anëtarëve të Besëlidhjes, i cili do të mbledhej herë pas here për çështje të rëndësishme.

Vendim tjetër shumë i rëndësishëm i Kuvendit ishte krijimi i ushtrisë së përbashkët dhe caktimi i Skënderbeut si komandant i përgjithshëm i saj. Ushtria e Besëlidhjes përbëhej nga dy pjesë: nga forcat e përhershme dhe nga ato të përkohshme që mobilizoheshin vetëm në raste lufte... Kuvendi vendosi që pranë Skënderbeut të krijohet një arkë e përbashkët.

Skënderbeu, edhe pse u zgjodh kryetar i Lidhjes Shqiptare dhe komandant i përgjithshëm i ushtrive aleate, nuk kishte asnjë të drejtë mbi zotërimet e tyre. Ai ishte i pari mes të barabartëve. Çdo bujar i dha Lidhjes zotime për ta ndihmuar luftën me ushtri dhe me të holla. Ata ruajtën të drejtën të largoheshin nga Besëlidhja pa pasur ndëshkime. Partikularizimi i feudalëve zvogëlonte forcën e shqiptarëve. Qëndrimi i lëkundshëm i bujarëve në çastet kritike të luftës paraqiste një rrezik serioz drejt sukseseve... Për të arritur suksese kundrejt pushtuesit, Skënderbeu filloi të mos përfillte privilegjet e feudalëve separatistë. Gjatë veprimeve luftarake kundrejt armikut Skënderbeu nuk përfillti zotërimet e bujarëve aleatë, dmth. kur u fuqizua si autoritet, shkeli autonominë territoriale të bujarëve shqiptarë. Qëllimi ishte të bashkohen territorialisht e politikisht kundrejt Perandorisë Osmane e çdo armiku të mundshëm... këto veprime quan drejt konsolidimit të shtetit shqiptar dhe e ruajtën identitetin e tyre nën udhëheqjen e Skënderbeut.

Për t'i realizuar sa më shumë qëllimet e bashkimit të fisnikëve shqiptarë Skënderbeu bëri edhe lidhje martesore. Martesat në mes të familjeve të mëdha feudale krijuan edhe parakushte të lidhjeve politiko-ekonomike si dhe trashëgimore. Kështu që martesat e Skënderbeut me Donikën, vajzën e Gjergj



Arianitit, kishte për qëllim lidhjet e këtyre dy familjeve të mëdha feudale. Skënderbeu edhe motrën e vet, Mamicën, e martoi me Muzak Topinë. Lidhjet martesore në mes të familjeve të mëdha feudale të Kastriotëve, Arianitëve e Topiajve krijuan mundësitë e bashkimit miqësor që, në fakt, krijonte atmosferën e unifikimit më të sigurt, pavarësisht prej vështirësive që kishte... me lidhje martesore kishte vepruar edhe Gjon Kastrioti, i ati i Skënderbeut, si: Mara ishte martuar me Shtjefan Cernojnë e Zetës, Vlajka me Gjon Muzakën, Angjelika me Vladan Arianitin (vëlla i Gjergj Arianitit), Jella me Pal Stres Balshën.

Sukseset në betejat kundrejt Perandorisë Osmane e Besëlidhjes Shqiptare dhanë sinjalizime të një shteti të fuqishëm shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut. Prandaj, pavarësisht prej konkurrencës mes vete të vendeve me ndikim të kohës, Skënderbeu e konsideruan si një faktor kryesor në aleancat e mundshme kundrejt armikut të përbashkët të Perandorisë Osmane.

\*\*\*

Traktati i Paqes me Venedikun (më 4 tetor 1448) është dokumenti i parë që e njohim deri më sot, ku Lidhja e Princave Shqiptarë del si subjekt i pavarur në marrëdhëniet ndërkombëtare...

Në Evropën Juglindore u krijuan marrëveshje diplomatike me hungarezët e Janush Huniadit deri në vitin 1456 kur ai vdiq. Edhe përkundër marrëveshjeve të mira që kishin me Janush Huniadin, kishte momente të vështirësive edhe të natyrave të ndryshme, si në kohën kur u bë marrëveshja që Skënderbeu t'i dilte në ndihmë Huniadit në luftë kundrejt P. O. që do të zhvillohet më 18 tetor 1448 në Fushë-Dardanë. Ishin momente tejet të vështira për Skënderbeun për tri arsye: 1. Qëndrimi i despotit serb Gjergj Brankoviçi pengonte trupat e Skënderbeut të kalonin nëpër tokat që zotëronin në atë kohë; 2. Konflikti me Venedikun...; 3. Besnikëria ndaj fjalës së dhënë (por rrethanat ishin të atilla që vërtet ishte e pamundur që Skënderbeu të jetë i pranishëm në betejë, pavarësisht insistimeve).

Përkundër vështirësive që ekzis-

tonin me despotatin serb për arsye të rivalitetit për territore, ishin momentet kur edhe u rregulluan marrëdhëniet diplomatike, sidomos pasi që Despotati i Rashkës ra në duart e osmanëve, despoti i saj, Stefani, djali i Gjergj Brankoviçi, u strehua në Shqipëri më 1459 për disa vite pranë Skënderbeut. Për t'i forcuar lidhjet diplomatike kundrejt armikut të përbashkët, Stefani u bë edhe baxhanak me Skënderbeun, duke e marrë për grua Angjelinën, vajzën e Gjergj Arianitit.

Me marrëdhëniet diplomatike me Bosnjën u treguan përafrime me mbretin e Bosnjës, Stefan Tomasheviçin, në rastin e konfliktit me Venedikun më 1448. Por për arsye të konflikteve të mundshme me Perandorisë Osmane nuk patën ndonjë marrëveshje të suksesshme me Skënderbeun.

Në pranverën e vitit 1463, kur ushtria osmane filloi pushtimin e Bosnjës, Skënderbeu ishte i gatshëm t'i ndihmonte, por ndërsa pritej vendimi i Republikës së Venedikut për ta lejuar kalimin e luftëtarëve shqiptarë nëpër rrugët e zotërimeve të saj, ushtria osmane e pushtoi Bosnjën. /Vijon

## EMIGRIMET SHQIPTARE DHE PERSPEKTIVA E EUROPEIZIMIT TË ALBANOLOGJISË (2)

**Orientimet e Çabejt**

Begzad BALIU

**Shqetësimet e Mithat  
Frashërit**

Le t'i referohemi më tej Lumo Skendos nga viti i largët 1928, i cili problemin e mungesës së teksteve dhe dokumenteve historike për mesjetën e diskuton në këtë mënyrë: Me qenë se, nga zaptimi i Konstatinopojë së dhe gjer më 1912 vendi ynë mbeti nën sundimin e imperatorisë otomane, kupëtohet vetiu se, çdo ngjarje në këtë mbretëri të gjerë ka influencuar moralisht dhe materialisht Shqipërinë: kështu që, historia e Tyrqisë ose më mirë të themi, historianët e Tyrqisë, pa dashurë dhe tërthorazi janë dhe historianët tanë. (. . .) Studimi i literaturës së historike tyrke do të hedhë mjaft dritë mbi çë kanë mundur të ngjajnë në Shqipëri makar dhe ashtu si i kanë parë këto ngjarje sytë zyrtarë të shkrimtarëve.

Në këtë rrjedhë ndërkaq për autorin e këtij diskutimi brilant edhe për kohën tonë, pas rreth një shekulli, paraqiteshin vështirësi, për faktin se kërkimet donin specialistë të tri varianteve të gjuhës së Perandorisë Osmane, të cilët atëherë mungonin, e sot pas një gjysmë shekulli mungojnë edhe më shumë.

Për t'i ardhur në ndihmë ndërkaq këtij kërkimi autori propozonte një kërkim shtesë. Ai mendonte me të drejtë se, për të plotësuar atë që mund të mungonte në botimet e orientit, përkatësisht në botimet e gjertanishme të Historisë së Perandorisë Osmane, për më shumë se pesë shekuj kërkimet në Veneci, pra në burimet e këtij vendi ku sheshoheshin më fort marrëdhëniet e popullit shqiptar me Perandorinë, ishin të një rëndësie të veçantë, për faktin se këto marrëdhënie shpesh në botimet osmane heshtnin apo paraqiteshin në mënyrë të njëanshme. Në parim ky hulumtim duhet të fillonte me një bibliografi të Tyrqisë, për librat në gjuhët e huaja, ku mund të identifikoheshin episodet brilante të zonave gjysmë autonome të Perandorisë së dy kontinenteve.

Le t'i rikthehemi përsëri Lumo Skendos, për shkak të gjenialitetit të tij prej një shekulli për orientimin e kërkimeve shkencore edhe sot. "Durimi dhe erudizioni i kërkimtarëve të historisë shqipëtare, shkruante Skendo, - nuk do t'ushtërohet vetëm në qytetin e lagunave; thesarë kartrash me rëndësi për neve janë edhe në kryeqytetet e tjerë: në Romë, në Raguzë, në Milano... Në Romë vjen me pare se çdo arhiv ay i Vatikanit, komunikata të misionarëve, korespondenca me ipeshkvitë, një land'e madhe për të cilën ekzistojnë katalogë dorëshkrim, po s'dimë të jetë shtypurë gjë. Pranë Vatikanit vjen landa e Propaganda Fide-së e cila në këta treqint vjet të fundit (themeluarë më 1622) është okupuarë posaçërisht me qendratë katolike të Shqipërisë. Kartërat e Raguzësë janë studiuarë prej autorëve të Acta e diplomata, po nukë munt kurrë njeriu të jetë sigur që nuk'ka mbeturë gjë akoma. Këta autorë kanë shkruarë prej dore edhe ç'ka qën'e e mundurë të gjejnë në Zagreb, në thesarin e ruajtura në bibliotekë të Akademisë. Po edhe sa qytete mbeten akoma të pa kërkuarë? Na, për shëmbllë Barcelonë, që mban arhivat e mbretërisë Napolit dhe Aragonësë, afëro dy milion akte, të pa prekurë

prej no një katastrofe, komplektë. (. . .)

Nukë do neglizhuarë, mbi këtë, as një bibliotekë, as një arhivë, sidomos thesarët intelektual të Italisë, të Vjenësë, të Parisit, të Londrës, të Oxfordit... Mos harojmë në këtë mes kancelarit'e Shtetëve të ndryshme, korespondencat zyrtare midis dy qeverive ose raportet e Ambasadorëve dhe konsujvet të tyre: Vjena, Petersburgu, Londra, Parisi, Stambolli, Athina... kanë faqe të tëra të historis's'ënë së re, sa edhe gjer Korfu.

Në Gusht të këti moti Ambrosiana e Milanit ishte mbyllurë; prefekti i saj, me gjithë këtë, më dha shpiegimet e duhurë mbi arhivat e ruajtura në institut të tij duke më thënë se, pas një tradicioni, në Ambrosiana qënkësh ruajturë më i vjetri monument në gjuhët shqip. Kjo pandehje do vërtetuarë. Një katalog metodik mungon".

Një rrjedhë të këtyre të dhënave shumë të rëndësishme Lumo Skendo jep edhe një letër komunikimi me Shuflain, i cili në të gjallë të tij i shkruante se "prej arhiveve të Barcelonës, të Milanit, të Mantues, dhe të Palermit kam në dorë materialin e duhur deri në vjetin 1501. Dokumentat e Barcelonës (mbi Skënderbegun) ia kam uhajtur përpara dy vjetvet Profesorit t'Universitetit të Beogradit Dr. Jovan Radoniç-it, por deri sot nuk m'i ka kthyer ende. Një dëshmi e tij shumë interesante për të cilën historiografia jonë ka heshtur deri më sot.

Në cilat institucione shkencore të trashëgimisë së albanologjisë ka bërë kërkime brezi i Mithat Frashërit në fillim të shekullit XX, brezi i studiuësve shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit XX, pra brezi i institucioneve të krijuara, dhe më në fund brezi i sotëm i albanologëve shqiptarë të shpërndarë gjithandej nëpër botë? Për brezin e Lumos Skendos na flet autori: pra fjala është për Nikolla Jorgën dhe në mënyrë të veçantë Shuflain me dy miqtë e tij të tjerë. Për më tej? Pak tepër pak dhe atë në mënyrë simbolike.

Për brezin e dytë të gjysmës së dytë të shekullit XX, kemi të dhëna pak më shumë. Një numër i kufizuar i studiuësve të dërguar në Vatikan në 500 vjetorin vdekjes së Skënderbeut, dy a tre studiuës të dërguar në Stamboll dhe Paris për të parë disa dosje të periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe së fund kërkime më intensive pothuajse individuale në Bukuresht, në Austri dhe Londër, gjithashtu për periudhën e Lidhjes së Prizrenit dhe Shpalljen e Pavarësisë. Asgjë më shumë.

Gjendja e kërkimeve albanologjike sot Diskutohet shumë për kërkimet e studiuësve shqiptarë, kryesisht të vullnetit ë mirë, por rezultatet konkrete nuk shohim. Duke qenë kërkime individuale dhe të rastit dhe dokumentet që vinë nga andej shpesh janë të tilla: të rastit, të paverifikuara dhe ndonjëherë madje të njohura që më parë.

Kërkimet janë të suksesshme vetëm kur për Arkiva të caktuara të kishim inventarët e njësive albanologjike që më parë, pra kur kemi që më parë indicie. Sigurisht arkivistët tanë do të thonë se inventarët, pasqyrat e dosjeve i ka secili Arkiv, por ne duam të kujtojmë gjithashtu se edhe pasqyrat janë aq të shumta sa vështirë është të kontrollohen të gjitha, para se të

bëjmë porosinë apo kërkimin. E vërteta sot Arkivat e shumta kanë krijuar dosje të tëra në formë elektronike dhe një pjesë e kërkimeve mund të bëhen duke qenë vetëm të akredituar pranë këtyre Arkivave, por ne pyesim: cili prej arkivave tona shtetërore a kombëtare ka sektorin e tij të veçantë të specializuar për kërkime elektronike pranë institucionit të tyre.

A kemi bërë ne kërkime në Dosjet e bardëve të Albanologjisë: Lajbnicit, ku edhe sot, jo vetëm në dosje po edhe në veprat gjithëpërfshirëse të botuara më parë, u gjetën të dhëna shumë interesante për shqiptarët në Ballkan; në dosjen e Hahnit, e cila mund të jetë shumë më e pasur nga sa duket për shqiptarët dhe popujt fqinjë në Ballkan; në dosjen e Gustav Majerit, tek e cila mund të gjenden shumë dorëshkrime të rilindësve shqiptarë dhe dokumente të raporteve të tij me administratën e Sulltanit; në dosjet e Norbert Joklit, ku mund të gjendet jo vetëm dorëshkrimi i Fjalori i etimologjisë së shqipes, po edhe shumë dorëshkrime të tjera; në dosjen e Durhamit ku mund të gjenden edhe shumë të dhëna të tjera për shqiptarët dhe popujt përreth; në dosjen e Eric Hampit, ku mund të gjenden raportet e tij për gjendjen e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, në dosjen madje edhe të një personaliteti të shquar të proveniencës së shkollës austriake sikur është Gjergj Pekmezi, në dosjen e të cilit sikur dihet gjendet edhe dorëshkrimi prej 8177 faqe të daktilografuara me materiale e relacione të konsujve austro-hungarezë të Shkodrës, Prizrenit, Janinës, Stambollit, nxjerrë nga Arkivi i Ministrisë të jashtme të Perandorisë Austro-Hungareze.

Me se i kemi nderuar deri më tash themeluesit dhe bardët e albanologjisë: Lajbnicin, Psilanderin, Hahnin, Majeri, Pedersenin, Joklin, Durhamin, Lamercin, Hempin, Mikdoshiqin, Cimohovskin etj. : kryesisht me ndonjë tekst (artikull) rasti brenda ndonjë konference shkencore, si dhe me një pagëzim të ndonjë rugice. Po me asnjë pagëzim institucioni kombëtar, me asnjë konferencë të veçantë themelvënëse (përjashtojmë Joklin, Majerin dhe Hampin) dhe në mënyrë të veçantë me asnjë monografi shkencore akademike, të cilat nuk mund të bëhen pa kërkime të gjata në institucionet ku kanë punuar dhe vendet ku kanë jetuar ata.

Me dekada jemi ankuar se kemi qenë të pushtuar dhe nuk kemi mundur të organizojmë diasporën shqiptare; me vite jemi ankuar se kemi qenë të rrethuar e vetretuar dhe nuk kemi pasur komunikim të mjaftueshëm me diasporën shqiptare. Kush na pengon ta organizojmë mërgatën tonë, tani që në qeveritë tona kemi ministra e administratë, të cilët merren vetëm me mërgatën; kush na pengon që asaj t'i japim rolin që nuk e ka pasur deri më tash: rolin e ambasadorit e diplomatit, që nuk e ka vetëm misionin politik po edhe kërkimor e shkencor. Kush na pengon tani që në qendrat më të mëdha të vendosjes në Vatikan, në Stamboll, në Londër, në Vjenë, në Paris etj., të kemi institucionet tona shkencore, apo përkrahjet e veçanta për përkrahjen e projekteve kërkimore të atyre studiuësve që jetojnë atje, në vend se t'i dërgojmë

ne nga Prishtina, Tirana apo Shkupi. Shembuj të mirë të këtyre suksesëve nuk na kanë munguar dekadat e fundit. Asnjë institucion i yni arsimor dhe shkencor, nuk do të arrinte të kurorëzonte hulumtimet që ka realizuar ekipi i studiuësve rusë për trashëgiminë shqiptare në Ukrainë. A nuk është kjo arsye e mjaftueshme që këtij ekipi t'ia bashkojmë edhe ndonjë të ri të specializuar nga radhët e mërgatës shqiptare atje. Ka disa dekada që kemi korrur rezultate të individëve (kryesisht) nga radhët e priftërinjve në vjeljen e dokumenteve në Vatikan për gjuhën dhe kulturën shqiptare, por koha është të ngremë institutin e kërkimeve shqiptare duke financuar djemtë e vajza nga radhët e diasporës, të cilët nuk mungojnë, por nuk kemi bërë ende asgjë që t'i organizojmë brenda një qerthulli. Ka disa vite që vlerësojmë dhe nderojmë përpjekjet dhe punën e madhe që ka bërë njëri prej albanologëve më të shquar të kohës sonë: Robert Elsie. Nuk thuhet ndërkaq se rezultatet e tij janë njëkohësisht edhe kërkimet shkencore që i ka bërë dhe përkrahur njëkohësisht kolegu i tij i diasporës shqiptare Bejtullah Destani, me largimin e të cilit nga Londra dhe Roma, pothuajse është shuar zëri i lajmeve të gëzueshme që vinte vite me radhë për zbulimet dhe botimet e atjeshme në fushë të albanologjisë. Në Shën Petërsburg, në Pekin dhe në Beograd, në Berlin, po realizohen katër projektet më të mëdha të albanologjisë: të gjitha në fushë të leksikografisë. Dy prej projekteve janë rezultat i studiuësve nga diaspora shqiptare, ndërsa dy projektet e tjera janë të studiuësve vendorë. Asnjëri prej tyre nuk përkrahët nga institucionet tona arsimore dhe shkencore, pavarësisht se janë projekte gati të paarrtshme për tu realizuar nga institucionet tona shkencore dhe arsimore. Projekte të jashtëzakonshme dhe madje të paarrtshme në fushën e albanologjisë për kapacitetet shkencore që kemi në institucionet shkencore të Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit po realizohen në Universitetin e Palermos drejtuar nga Metteo Madala dhe Universitetin e Kalabrisë drejtuar nga Profesor Francesco Altamari, por projekte të kësaj natyre nuk po realizohen as në Prishtinë, as në Tiranë e as në Shkup e Tetovë, ku janë përqendruar qendrat më të mëdha të kërkimeve shkencore.

**Në vend të përfundimit**

Në vend të përfundimit, le t'i rikthehemi përsëri Profesor Çabejt: Shqiptarët janë bartës të një kulture popullore të lashtë në këtë zonë të Evropës. Kjo kulturë përmban disa tipare vetjake të trashëguara, që dallohen nga ato të kulturave popullore të tjera të kësaj zone. Dhe kjo kulturë nuk ka qenë as në të kaluarën një kulturë thjesht baritore, si është thënë e vazhdon të përsëritet shumëkund edhe ndër qarqë shkencore kompetente. Po të mbahen parasysh terminologjia e pasur e jetës shoqërore, me terme si besa që ka shkruar në mbarë gjuhët ballkanike e gjer në turqishtë, doket e zakonet e shqiptarëve, nomenklatura popullore e mjeshtërive të ndryshme, do të gjykohej në mënyrë objektive kultura popullore shqiptare karakteri produktiv i saj ndaj të tjerave kultura popullore të Ballkanit.

(FUND)

Flet Daut Dauti

# KRIJIMI I SHQIPËRISË NË LONDËR SI REZULTAT I NJË KOMPROMISI TË FUQIVE TË MËDHA (3)

Intervistoi: Haqif MULLIQI  
Fotografinë: Agron SHALA

Në fjalimin e rastit, në promovimin e studimit tuaj, Noel Malcolm thotë se "Çështja shqiptare në diplomacinë britanike 1877-1880" thotë se, paqja se me temën që jepet në këtë studim janë marrë edhe autorë të tjerë, por askush më parë nuk e ka trajtuar çështjen shqiptare të kësaj periudhe siç u bë me këtë rast. Malcolm, gjithashtu bëri me dije se ju, në mënyrë të palodhshme shkencore, keni trajtuar në hollësi më të imëta ngjarjet e asaj kohe që ishin të rëndësishme për popullin shqiptar dhe për historinë e rajonit dhe asaj evropiane. Ai shton, gjithashtu, se falë përmbajtjes së librit për të cilin po flasim, bëhet me dije situata në terren dhe cilësimi i tyre nga diplomatët britanikë që dalin nga raportet e tyre që ata ua kanë dërguar qeverisë së tyre në Londër. Vlerësim i veçantë i historianit të shquar për veprën tuaj.

**DAUTI:** Noel Malcolm është ndër historianët dhe intelektualët sipëror dhe më të njohur botëror. Në Ballkan ai njihet për librin mbi historinë e Bosnjës dhe atë të Kosovës, dy veprat më të mira që janë shkruar për këta dy popuj. Por, Noel Malcolm në Britani të Madhe dhe në botë më shumë njihet si një ndër studiuesit më të mirë të Thomas Hobbesit. Duke qenë hulumtuës i lartë në Oxford, ai ka shkruar edhe një varg veprash të tjera, përfshirë "Agjentët e Perandorisë", një vepër po ashtu të njohur për dy familjet shqiptare të Ulqinit. Para disa muajve ai ka botuar edhe një libër që quhet "Useful Enemies" (Armiqtë e dobishëm). Ky libër, ku studiohen arsyet dhe shkaqet e ndarjes në mes të Lindjes dhe Perëndimit, si çdo libër tjetër i tij është vlerësuar lart nga lexuesit dhe kritikët. Noel Malcolm, mbi të gjithë, është mik i shqiptarëve dhe kryetar i Shoqatës Anglo-Shqiptare me seli në Londër, e cila është themeluar nga Aubrey Herbert gjatë Luftës së Parë Botërore. Malcolm ka folur për librin tim me rastin e promovimit në Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Londër dhe ky është ndër i madh për mua.

Çfarë thonë britanikët, sidomos për ngjarjet në Vilajetin e Kosovës dhe për kufirin me Serbinë në vitin 1877, pra në prag të organizimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe cilat ngjarje mund t'i veçoni e që ndërliken me Vilajetin e Kosovës, sidomos në kufi me Serbinë në vitin 1878?

**DAUTI:** Edhe pse negociatat për paqe në mes të Serbisë dhe Perandorisë Otomane kishin përfunduar në fillim të marsit 1877, në gusht të atij viti Beogradi haptas përgatitej për sulme të reja. Konsulli White njofton për një mobilizim të madh të forcave serbe që përgatiteshin për t'u dërguar në jug, gjegjësisht në drejtim të Kosovës. Ky mobilizim, në fakt, kishte për qëllim

okupimin e territoreve të reja dhe përzënie e shqiptarëve nga vendet që ranë nën sundim të Serbisë. Me këtë lëvizje serbët kishin për qëllim që t'i destabilizonin edhe më tej territoret shqiptare brenda kufirit otoman. Beogradi, po ashtu, dha shenja se do të sulmonte në drejtim të Bosnjës e cila gjë i shqetësoi diplomatët evropianë në Beograd pasi që një gjë të tillë nuk do ta toleronte Vjena e cila e kishte shpallur Bosnjën zonë të interesit të vet. Për këto plane britanikët ia tërhoqën vërejtjen qeverisë serbe. Sulmi serb në drejtim të Bosnjës nuk ndodhi, por ajo që diplomatët shënuan në Beograd ishte fakti se serbët, në krye me princ Millanin, kishin filluar t'ia kthenin shpinën Vjenës e të orientoheshin në drejtim të Rusisë. Shtimi i influencës ruse vërehej gjithandej në Serbi. Kjo lëvizje e re ishte rrezik për Ballkanin dhe bëri që të shuheshin shpresat e liberalëve serbë për kthim kah Evropa.

Një prej figurave të përfolura në historiografinë tonë është ajo e Ali Pashë Maxharit i cili u vra nga luftëtarët e Lidhjes në Gjakovë. Pse ky pasha osman e bëri të tërë atë përpjekje për t'i bindur shqiptarët që t'i zbatonin vendimet e Kongresit të Berlinit?

**DAUTI:** Mehmet Ali Pasha dhe Karateodori Pasha kanë qenë përfaqësues fuqiplotë të Perandorisë Otomane në Kongresin e Berlinit. I pari ka qenë gjerman i konvertuar në mysliman dhe, për shkak të origjinës së tij, shqiptarët e quanin Ali Pashë Maxharin. I dyti ka qenë grek dhe kishte bërë karrierë të suksesshme pasi që ishte i biri i mjekut personal të sulltanit. Kjo nuk është ndonjë çudi për shkak se në shërbim të diplomacisë apo të politikës së jashtme otomane, shumica e funksionarëve kanë qenë të krishterë. Sidoqoftë, që të dy pashallarët janë orvatur që në Berlin ta përfaqësonin Portën e Lartë me dinjtet, duke u munduar që të ruajnë territor sa më shumë që ishte e mundshme. Aktiviteti i Ali Pashës që e tregoi në këtë drejtim, e kishte shtyrë kancelarin gjerman, princin Bizmark, që t'i thoshte pashës se në Berlin kishte ardhur për t'i dëgjuar dhe pranuar vendimet e jo për të paraqitur kushte pasi që po e përfaqësonte palën humbëse. Madje Bizmarku shkante aq larg sa që e shpotiste Ali Pashën për ta nënçmuar. E quante 'der Magderburger', sipas vendit ku kishte lindur në Gjermani.

Kur u diskutua çështja e Tivarit, Karateodori Pasha e kundërshtoi rreptë kalimin e këtij qyteti në posedim të Malit të Zi. Ai theksoi se qyteti ishte i banuar me shqiptarë dhe se padrejtësisht po ndahej nga një tërësi etnike dhe po kalonte në një tërësi me të cilën s'kishte asnjë lidhje. Vërejtja e Karateodorit nuk u mor parasysh në seancën e marjes së vendimeve. Por, ajo që është më rëndësi është fakti se Karateodori Pasha, duke e kundërshtuar



vendimin, e kishte ngritur për diskutim çështjen kombëtare shqiptare, e cila, po ashtu, u mohua.

Ali Pashë Maxharri u dërgua në Kosovë nga sulltani në mënyrë që t'i bindte shqiptarët që të mos iu rezistonin vendimeve të Kongresit të Berlinit dhe ta dorëzonin Plavën dhe Gucinë në posedim të Malit të Zi. Më 19 gusht Ali Pashë Maxharri ishte takuar me ambasadorin britanik në Stamboll, Henry Layardin, të cilit i kishte treguar se po shkonte në Kosovë me detyrën që e kishte ngarkuar sulltani. Pasha mbërriti në Prizren më 24 gusht dhe kërkoi nga udhëheqësit e Lidhjes së Prizrenit që t'i pranonin kushtet e Berlinit. Propozimi i tij u refuzua kategorikisht dhe pasha vendosi ta vazhdonte rrugën për Plavë e Guci dhe në fillim të shtatorit u ndal në Gjakovë, ku u vra nga anëtarët e Lidhjes. Pasha, duke mos e pasur parasysh sa kishte ndryshuar situata, e kishte gjykuar gabimisht gjendjen që e kishin krijuar shqiptarët dhe në këtë mënyrë ai u bë viktima e parë e vendimeve të Kongresit të Berlinit. Vrasja e tij e ndryshoi gjendjen edhe më shumë. Pas kësaj ngjarje, Fuqitë e Mëdha praktikisht më nuk dinin se si të vepronin, kurse shqiptarëve iu shtua dëshira për mëvetësim nga Porta e Lartë.

Si u vendos në këtë periudhë, pra pas Kongresit të Berlinit, kufiri ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe pse Përpellaci, një lokalitet shqiptar në vetë kufirin me Serbinë edhe sot, ishte një prej pikave më të ndjeshme për vendosjen e kufirit ndërmjet Perandorisë Osmane dhe Serbisë. Pse ndodhte kjo?

**DAUTI:** Kufiri i Serbisë me Kosovën, sikur edhe ai me Malin e Zi dhe Greqinë, doli të ishte më problematik sesa që u mendua në Berlin. Diplomatët britanikë ishin në dijeni se serbët kishin ndarë shumica të mëdha të parave për t'i korruptuar anëtarët e komisionit të kufirit me Kosovën dhe Bullgarinë. Përpellaci doli të ishte vështirësi e madhe për caktimin përfundimtar të kufirit me Kosovën. Ky vend ishte strategjik pasi

që nga aty kontrollohej një pjesë e madhe e Kosovës. Prandaj, u bë temë e diskutimeve në ministrinë e jashtme të shteteve evropiane. Interpretimi i traktatit thoshte se kufiri caktohej sipas ndarjes së ujërave, por këtë e kundërshtonte Serbia pasi që pjesa më e madhe dhe më strategjike i mbetej Kosovës. Kundërshtimi i Serbisë e detyroi lejtënantin Blandensburg që ta vizitonte rajonin, ku u bind se edhe banorët ishin shqiptarë. Konsulli britanik në Beograd u detyrua që princ Millanit t'ia numëronte të gjitha masat e rënda që qeveria serbe kishte ndërmarrë për t'i përzënë nga trojet e tyre shqiptarët që nuk ishin lejuar të merrnin asgjë me vete. Më në fund, Serbia, e cila nuk i pranonte hartat austro-hungareze që ishin caktuar në Berlin, u tërhoq nga Përpellaci dhe kufiri verior i Kosovës me Serbinë që u caktua atëherë, ekziston edhe sot.

Si po raportonte për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit lejtënant Bladensburg dhe çfarë thonë ato raportime?

**DAUTI:** Qeveria britanike informohej nga terreni nëpërmes përfaqësive të rregullta konsullore dhe diplomatike të veta. Kishte raste që dërgonte diplomatët të përkohshëm. Në raste të krizave apo konflikteve dërgonte ushtarakë të cilët kishin detyra të caktuara dhe përgatisnin raporte që u shërbenin qeverisë në Londër. Në vilajetin e Shkodrës dhe Kosovës, Londra ka dërguar disa herë oficerë për këtë qëllim. Një nga ta ka qenë lejtënantin Blandensburg. Ai ka bërë disa raportime për nevojat e Foreign Office-it, por më i njohuri është ai për gjendjen në Kosovë gjatë vitit 1879. Në raportin e tij bëhet me dije për gjendjen e rëndë në Kosovë pasi që ky vend ishte mbushur me refugjatë nga Serbia të cilëve u mungonin edhe gjërat më elementare. Një gjë e këtillë e kishte radikalizuar situatën politike, por Lidhja e Prizrenit, me organizimin e saj adekuat, ia dilte që me sukses të përballohej me këtë problem dhe situata të tjera të vështira.

Raportet të kësaj natyre janë dërguar

shpesh në Londër. Me to është bërë informimi që ka qenë i rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes. Por, këto raporte sot na shërbejnë edhe si materiale të rëndësishme për pasurimin e historisë sonë.

Cilat ishin aktivitetet diplomatike dhe masat ushtarako-policore të Serbisë për zgjerim të territoreve dhe përzënie e shqiptarëve nga trojet e tyre etnike në këtë kohë dhe si u dëbuan shqiptarët nga Nishi?

**DAUTI:** Dokumentet britanike bëjnë me dije se deri në vitin 1878 Nishi ka qenë qytet i rëndësishëm për shqiptarët, turqit, serbët, bullgarët dhe hebrenjtë. Pjesa më e bukur e qytetit ka qenë lagjja e shqiptarëve (Arnaut Mahalles) që ka pasur 300 shtëpi. I tërë qyteti ka pasur rreth 1 500 banorë shqiptarë. Pas vitit 1878 në qytet ka pasur vetëm serbë pasi që të gjithë të tjerët janë përzënë me dhunë. Në shënjestër të veçantë të dhunës kanë qenë shqiptarët pasi që ekonomia dhe politika e këtij qyteti kanë qenë në duar të shqiptarëve. Shtëpitë më të bukura kanë qenë të shqiptarëve dhe në to u vendosën oficerët dhe zyrtarët e tjerë serbë. Nga një raport që konsulli otoman, Nikollaides, ia dërgon nga Nishi konsullit britanik në Beograd, merret vesh se vlera e pasurisë që shqiptarët kanë lënë pas ka qenë 2 milionë piastra. Qeveria serbe, nën presionin britanik, ka marrë obligim të kompensimit të shqiptarëve. Por, këtë obligim serbët nuk e kanë përmbushur kurrë. Konsulli Nikollaides, po ashtu, ka bërë edhe një listë që përmban disa qindra fshatra të tjera të jugut të Serbisë nga ku janë përzënë shqiptarët. Qeveria serbe edhe për këto fshatra është zotuar se do ta sigurojë kthimin e atyre që janë përzënë dhe kompensimin e shqiptarëve që nuk dëshirojnë të kthehen. Asgjë nuk është përmbushur as nga ky premtim. Brenda një periudhe të shkurtër pothuajse i tërë qyteti u rrëzua, me arsyetim se po aplikohet një plan i ri urbanistik.

(Marrë nga numri i shtatë i revistës "Akademia". Vijon në numrin e ardhshëm)

E jashtëzakonshme

## Gjobë për çdo 5 minuta vonesë, vendimi drastik i shkollës fillore 'shokon' prindërit

Një shkollë fillore në Kent të Anglisë ka vendosur t'i gjobisë prindërit nëse nuk marrin në kohë fëmijët e tyre. Gjoha është 1 paund për çdo 5 minuta vonesë pas orës



15:40. Shërbimet sociale do të kontaktohen nëse një fëmijë mbetet 'vetëm' deri në orën 16:00, sipas një politike të prezantuar në fillim të këtij muaji.

FOTO E DITES



Pamje e bukur dimri në bjeshkët e Deçanit

E rrallë

## Një qenush lind me ngjyrë të çuditshme

Një qenush në Karolinën e Veriut ka lindur me ngjyrë jeshile, që me kalimin e kohës po kthehet në të verdhë, dhe arsyeja do t'ju befasojë. E zonja e këlyshit, Shana Stamey, ka thënë për një media lokale se u frikësua kur e pa. Megjithatë, nuk ka asgjë për t'u shqetësuar pasi ngjyra e çuditshme është shkaktuar nga "mekoniumi", jashtëqitjet e para të një



qenushi të porsalindur, në mitrën e gjtares. Raportime të mëparshme kanë zbuluar raste kur kafshët kanë ngordhur pasi janë mbytur nga pigmenti në mekonium.

## BARSOLETA E DITËS



Mësuesja: Sa bëjnë 2+2 libra?  
Nxënësi: 4.  
Mësuesja: Po 3+5?  
Nxënësi: 8.  
Mësuesja: E 100+200 libra?  
Nxënësi: Librari!



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



#### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



#### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min  
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.  
**Regjia:** J.J. Abrams




#### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



**DASHI**  
Çështjet sentimentale po evoluojnë në favorin tuaj. Miqësitë janë gjithmonë të dobishme jo vetëm nga ana sentimentale.



**DEMI**  
Asgjë për të ankuar në fushën e dashurisë. Partneri do t'ju japë shikime të buta, do t'ju flasë në gjuhën e gjesteve.



**BINJAKËT**  
Sot nuk ka asnjë gjë që të ketë interes apo rëndësi për ju. Do të jetë një ditë e qetë, prandaj merruni me ndonjë hobi.



**GAFORRJA**  
Një dorëzim i pazakontë ju bën më të dashur. Sa i përket marrëdhënieve, përpuni të privilegjoni ato të rëndësishmet.



**LUANI**  
Hëna kundër teje. Mos kërkonit të keqen aty ku nuk është aty. Mos u kushtëzoni nga përvoja negative e jetuar me një person që mendonit se ishte mik.



**VI RGJËRESHA**  
E diela, falë hënës në akrep, do të kalojë këndshëm në paqe. Jepni një shoku pak vëmendje dhe kohën tuaj.



**PESHORJA**  
Nëse do të arrini t'i përballoni ato, kaloni vëmendjen të familja juaj. Përqendrohuni te pamja fizike dhe çështjet shëndetësore.



**AKREPI**  
Do të bëni një ndarje të mirë të projekteve dhe do të përjetoni çaste intime me të dashurin tuaj. Nëse jeni beqar, një miqësi po konsolidohet gjithnjë e më shumë me kontakte telefonike.



**SHIGJETARI**  
Hëna në fushën e dymbëdhjetë. Nuk do të jetë një e ditë e lehtë, nëse ndonjë prej jush po kalon një periudhë krize emocionale.



**BRICJAPI**  
Të nxitur nga një qiell i shkëlqyeshëm, ju mund të shpërqendroheni nga problemet personale dhe familjare.



**UJORI**  
Mundohuni të qëndroni i qartë në mënyrë që të mos humbni atë që është bërë më parë.



**PESHQIT**  
Tendanca e dashurisë duket se është shumë e favorizuar, por gjendja shpirtërore dhe shëndeti janë gjithashtu të shkëlqyera sot.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

# SPORT

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

# Peja fiton derbin ndaj Prishtinës



## "Epoka e re"

**PEJË, 19 JANAR** - Skuadra e Pejës e ka fituar derbin ndaj rivalës së vjetër, Prishtinës, me rezultat 82:76 (22:7, 29:25, 19:27, 12:17). Ndeshja e zhvilluar në "Karagaçi" ishte e jashtëzakonshme, kurse ekipi pejan e mposhti pa ndonjë problem të madh skuadrën nga kryeqyteti, në superderbin e javës së 21-të të Superligës së Kosovës në basketboll. Vendasit, të motivuar nga tifozët, e nisën për mrekulli ndeshjen, duke dominuar në çerekun e parë, që e fitojnë 22:7. Megjithatë, në periodën e dytë zhvillohet një lojë më e baraspeshuar, por "Verdhezinjtë"

sërish e fitojnë 29:25, duke shkuar në pushim me rezultat 51:32. Në periodën e tretë rikthehen fuqishëm "Bardhekaltrit", duke afruar shifrat në 59:52, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash tregonte shifrat 70:59 për vendasit. Mysafirët në 10 minutat e fundit arrijnë të afrojnë edhe më shumë rezultatin, duke e bërë ndeshjen edhe më dramatike. Dy minuta pa përfunduar sfida, Prishtina ngushton epërsinë në 76:73, por Peja arriti ta ruajë epërsinë e krijuar dhe në fund triumfoi 82:76. Dardan Berisha ishte më i miri te Peja me 26 pikë, tri kërcime dhe katër asistime, derisa u ndihmua nga Drilon Hajrizi me 15 pikë e 13 kërcime, kurse te Sigal Prishtina më

së shumti pikë shënuan Jordan Johnsoni 26 pikë dhe Anthony Goodsi 22 pikë. Peja tani ka 10 fitore dhe tetë humbje, kurse Sigal Prishtina 14 fitore dhe pesë humbje, aq sa ka edhe Rahoveci. Ndërsa të shtunën Rahoveci ka shënuar fitoren e radhës në Superligë, duke mundur Lipjanin me rezultat 97:76 (22:12, 22:26, 29:18, 24:20) në kuadër të xhiros së 21-të të Superligës së Kosovës në basketboll. Te "Vreshtarët" u dalluan Darell Davis me 24 pikë dhe Joshua McFolley me 23, kurse te Lipjani më i miri ishte Tamas Bruce me 32 pikë e 11 kërcime. Ndërsa fitore ka shënuar edhe Ylli ndaj Trepçës me rezultat 90:83 (26:21, 26:20, 16:23, 22:19).

## SHKURT

### Gustavo: Muriqi është sulmues i klasës botërore

Sulmuesi i reprezentacionit të Kosovës, Vedat Muriqi, është lavdëruar nga ish-mesfushori i Bayern Munchenit, Luiz Gustavo. "Jam befasuar kur e kam parë Vedat Muriqin. Nuk besoja që ishte një sulmues kaq i përkryer dhe një talent i madh. Ai është sulmues i klasës botërore", ka thënë Gustavo. Muriqi shënoi golin e dytë në ndeshjen Gaziantep FK - Fenerbahçe (0-2) dhe u ndëshkua me karton të kuq.

### Nora Gjakova, xhudistja më e mirë e Kampionatit Shtetëror

Xhudisja Nora Gjakova është shpallur xhudistja më e mirë e Kampionatit Shtetëror të Kosovës. Trajneri i xhudos, Driton Kuka, ka theksuar se Nora do t'i prijë ekipit të ri që do të marrë pjesë në Grand Prixin e radhës. "Ndarja e medaljes për Nora Gjakovën që u shpall xhudistja më e mirë e Kampionatit Shtetëror! Test i mirë para Grand Prix Tel Aviv, ku Nora do t'i prijë ekipit tonë të ri që do të marrë pjesë në Grand Prixin e radhës", ka shkruar Kuka në "Facebook".

### Lëndohet Kumbulla

Mbrojtësi shqiptar i Veronas, Marash Kumbulla, ka pësuar një lëndim në përballjen me Bolognan në xhiron e 20-të të Serisë A. Futbollisti dëmtoi syrin dhe si pasojë u detyrua të largohet nga ndeshja në minutën e 25-të. Ndeshja në mes të këtyre dy skuadrave përfundoi me rezultat 1-1.

### Berisha shënon dy gola për Western Unitedin

Western Unitedi ka shënuar fitore bindëse në shtëpi ndaj Central Coast Mariners, e fjalën kryesore e pati sulmuesi kosovar Besart Berisha. Ai shënoi dy herë në fitoren prej 3 me 0. Berisha shënoi një gol të bukur me kokë në minutën e gjashtë të takimit pas një krosimi nga Diamanti. Një autogol nga Rowles e dyfishoi epërsinë e vendësve në minutën e 18, kurse pas tre minutave Berisha e trefishoi epërsinë. Berisha arrin në kuotën e nëntë golave në 14 ndeshje në elitën e futbollit australian këtë edicion. Me këtë fitore Westerni mban vendin e pestë me 20 pikë, kurse në vendin e dhjetë Central Coast Mariners.

## Liverpooli mposhti Unitedin dhe i afrohet titullit

**LIVERPOOL, 19 JANAR** - Skuadra e Liverpoolit ka bërë edhe një hap të madh në rrugëtimin drejt titullit kampion në Angli, pasi të dielën e ka mposhtur me rezultat minimal 2-0 skuadrën e Manchester Unitedit. Kjo e fundit është e vetmja skuadër që i ka marrë pikë deri tash Liverpoolit në

Premierë Ligë, pra nga ndeshja e parë kur kishin luajtur baras. "Reds" shënoi golin e parë në minutën e 16-të nëpërmjet Virgil Van Dijk, i cili, pas një rivënies nga këndi, me kokë e hodhi topin në rrjetën e portierit David de Gea. Golin e dytë dhe të fundit në ndeshje e realizoi

Mohamed Salah në minutat shtesë. Pas kësaj fitoreje skuadra e Jurgen Kloppit ka grumbulluar 64 pikë, 16 pikë më shumë se Manchester City që renditet në vendin e dytë dhe ka një ndeshje më shumë të zhvilluara, ndërsa mbetet në pozitën e pestë me 34 pikë.



## Prishtina mbush bateritë në Turqi

PRISHTINË, 19 JANAR - Ekspedita e Prishtinës të dielën ka udhëtuar drejt Antalias së Turqisë për përgatitjet e stinorit pranveror. Klubi nga kryeqyteti i Kosovës do të qëndrojë 13 ditë në Turqi dhe atje do t'i zhvillojë edhe katër

ndeshje miqësore. Prishtina më 22 janar takohet me Ardan (Bullgari), kurse më 26 janar përballet me Kolos (Ukrainë). Kryeqytetasit e Kosovës më 28 janar zhvillojnë përballet me Chertanovo (Rusi) dhe më 30 janar kundër Ordabasy

(Kazakistan). Lojtarët që kanë udhëtuar janë këta 23 futbollistë: Visar Bekaj, Eglant Haxho, Alban Muçiqi, Armend Thaqi, Labinot Ibrahim, Leotrim Bektashi, Ahmet Haliti, Diar Miftaraj, Ermal Vitija, Tun Bardhoku,

Qëndrim Zyba, Lorik Boshnjaku, Ardit Hila, Endrit Krasniqi, Ergyn Ahmeti, Leonit Abazi, Meriton Korenica, Gauthier Mankenda, Kreshnik Uka, Ahmed Januzi, Oto John, Alban Shillova.



# Kampioni i boksit, Tefik Bajrami, kandidon për asamblist të qytetit të Luzernit

LUZERN, 19 JANAR - Në Zvicër ka shumë shqiptarë të suksesshëm dhe të integruar në shoqërinë zvicerane. Një ndër ta është edhe Tefik Bajrami, i cili ka qenë kampion boks në botë në versionin WBU. Por, ai tani ka vendosur që të bëjë diçka ndryshe. Përveç që është pjesë e aktiviteteve për integrim në qytetin e Luzernit, tani ai është edhe kandidat për asamblist. Bajrami në një intervistë të dhënë për "Albinfo.ch" ka zbuluar arsyen e vendimit të tij që të futet në politikë si dhe planet e tij se çka do të ndryshojë në qoftë se arrin që të zgjidhet asamblist. Si zgjedhës potencial të tij ai i ka parë edhe zviceranët, jo vetëm shqiptarët, por përkrahjen më të madhe e sheh te shqiptarët.



Jeni i njohur për komunitetin e këtushëm shqiptar nga aktivitetet tuaja që kanë të bëjnë me sportin, boksit etj., por jo edhe si politikan. Çfarë ju ka shtyrë që ta filloni angazhimin në politikë?

**Bajrami:** Unë jam në komisionin për integrim këtu në qytetin Luzern. Pasi jam personalitet publik, më ka shtyrë të angazhohem për diçka pozitive, në kuptimin që një shqiptar nga Kosova dhe kampion bote në boks dësh-

iron të kontribuojë për mirëqenien e qytetarëve.

Si e shpjegoni vendimin për të kandiduar pikërisht për CVP-në? Mendoni se ju si shqiptar po edhe komuniteti shqiptar në përgjithësi ndan vlera të përbashkëta me këtë parti?

**Bajrami:** Mendoj se partia demokristiane ka parë që Zvicra ka shumë të huaj dhe tash është

e hapur në këtë drejtim që edhe të huajt janë vendimmarrës këtu dhe kjo është për t'u përshëndetur.

*Cilat mendoni se janë gjasat dhe ku i shihni më shumë të koncentruar zgjedhësit tuaj potencialë: te komuniteti shqiptar dhe i huaj apo te zviceranët?*

**Bajrami:** Zgjedhësit potencialë mendoj se janë të gjithë banorët me të drejtë vote, si zviceranë, shqiptarë etj. Por, si shqiptar pres një mbështetje madhështore nga bashkëkombësit e mi. Unë sapo kam aderuar dhe CVP në qytet nuk është parti aq e madhe sikurse në kanton, ku është e para.

*Nëse do të zgjidheni, cilat do të jenë temat të cilat do t'i keni përparësi në punën tuaj si deputet?*

**Bajrami:** Nëse zgjidhem do të mundohem që vendet për fëmijët e vegjël, kopshtet e fëmijëve të subvencionohen më shumë, që prindërit me një të punësuar në familje të kenë mundësi t'i dërgojnë fëmijët nëpër çerdhe, kopshte etj. Sepse, është e domosdoshme që ata të jenë në mesin e moshatarëve të tjerë dhe që ekonomia në qytetin e Luzernit të lulëzojë më shumë.

## Lakersat triumfojnë në 'Toyota Center'

HOUSTON, 19 JANAR - Pavarësisht formës së shkëlqyer të Harden dhe Westbrookut, që shënuan 69 pikë, rikuperuan 15 topa dhe dhanë 14 asistime të dy së bashku, këto shifra nuk mjaftuan që Houston Rockets të triumfojnë ndaj Los Angeles Lakersit. Në "Toyota Center" të Houstonit miqtë ia dolën të triumfojnë me rezultatin final 115-124 falë një paraqitjeje të shkëlqyer të LeBron Jamesit, që regjistroi 31 pikë, 5 rikuperime dhe 12 asistime, ndërsa vendimtar ishte fraksioni i tretë që Lakersi e fitoi bindshëm 17-32. Pas dy humbjeve radhazi në shtëpi, ka ardhur edhe reagimi i Oklahoma City Thunderit, që arriti të triumfojë me rezultatin final 119-106 përballë Portland Trail Blazersit, në



një sfidë ku vendësit patën kontrollin e lojës gjatë gjithë kohës, pavarësisht formës së mirë të Lillardit dhe Trentit të miqtë. Vazhdojnë ngjitet kampionët në fuqi të Toronto Raptorsit, që regjistruan triumfin e tretë radhazi, këtë herë me shifrat 112-122 në transfertën përballë Minnesota Timberwolves, rezultat ky që i ngjiti në vendin e tretë në Konferencën e Lindjes. Pas 10 humbjeve radhazi rikthe-

het te suksesi edhe Golden State Warriors, që mposhti me rezultatin 109-95 Orlando Magicin, në "Chase Center" të San Franciscos, në një takim ku Russell ishte protagonist me 26 pikë të shënuara. Warriorsi ka qenë skuadra lidere e viteve të fundit në NBA. Për këtë sezon është shpërbërë dhe në 44 ndeshjet e para numëron vetëm 10 fitore e 34 humbje, duke u renditur në vendin e fundit në Konferencën e Perëndimit. Në sfidat e tjera, Philadelphia 76ers triumfoi me rezultatin e ngushtë 87-90 përballë New York Knicksit, Detroit Pistonsi mposhti bindshëm Atlanta Hawksin 136-103, ndërsa Utah Jazzi fitoi me rezultatin 123-101 përballë Sacramento Kingsit.

### SHKURT

#### Roma e kërkon Januzajn

AS Roma po interesohet për futbollistin shqiptar që mbron ngjyrat e Belgjikës, Adnan Januzaj, Sportitalia. Pas lëndimit të Nicolò Zaniolos, Roma në listë fillimisht kishte Suson dhe Shaqirin, por pasi nuk arriti marrëveshje me këta dy futbollistë e ka vënë në shënjestër Januzajn. "Roma është një prej klubeve të interesuara për Adnan Januzaj gjatë afatit kalimtar të janarit. Giallorossi është një klub i madh, kështu që atij i pëlqen ideja për t'u bashkuar. Për momentin nuk mund të jap hollësi", ka konfirmuar agjenti i tij.

#### Podolski largohet nga Vissel Kobe, rikthehet në Turqi

Lucas Podolski nuk është më një futbollist i Vissel Kobe. Klubi japonez, ku luajnë emra të tjerë të rëndësishëm nga Evropa si Andres Iniesta, Sergi Samper, Wellington dhe Thomas Vermaalen, nëpërmjet një komunikate ka zyrtarizuar lamtumirën e sulmuesit gjerman, i cili do të nisë një përvojë të re në Turqi te skuadra Antalyaspor. Në fakt, bëhet fjalë për një rikthim në Superligën e Turqisë për 34-vjeçar, që në sezonet 2015-2017 ka luajtur për Galatasarayn (20 gola në 56 ndeshje në kampionat). Kujtojmë që Podolski është shpallur kampion bote me Gjermaninë në vitin 2014. Në total, me "Panzerat" ka shënuar 49 gola në 130 ndeshje.

#### Tevezi pensionohet te Boca Juniorsi

Gjatë një interviste për mediat argjentinase, sulmuesi i Boca Juniorsit, Carlos Tevez, ritheksoi edhe një herë se dëshira e tij është ta përfundoi karrierën pikërisht te skuadra e Bocas. 35-vjeçari bëri me dije se gjatë muajit qershor do të marrë një vendim përfundimtar për të ardhmen e tij. Kontrata e sulmuesit me klubin argjentinase skadon pikërisht në qershor por, sipas mediave, drejtuesit mund të vendosin t'i rinovojnë kontratën lojtarit. Ajo që dihet dhe që tashmë është e qartë për të gjithë është se në karrierën e Tevezit nuk do të ketë fanella të tjera për t'u veshur.

#### Wilder, Furyt: Nëse dalin fjalët tua, unë pensionohem

Deontay Wilder ka futur edhe pensionimin në ekuacion, para revanshit me Tyson Furyt. Fury dhe Wilderi po përgatiten për revanshin e madh të shkurtit, ku do të kontestohet titulli i WBC-s. Para këtij dueli lufta e fjalëve është ajo që po vazhdon mes dy boksierëve, të cilët nuk kursejnë asgjë për njëri-tjetrin. Fury ka insistuar se do ta nokautojë kampionin e WBC përbrenda dy raundeve të para, kurse përgjigja e amerikanit ka qenë epike. "Askush nuk e beson atë. Ai thotë se do të më nokautojë në raundin e dytë. Është gjë që nuk besohet" ka thënë Wilderi. "Kam edhe gjashtë vjet karrierë në sport, por nëse ai më rrëzon në raundin e dytë? Më nokauton? Unë mbaroj. Unë i jap fund. Pikë" ka thënë tutje 'Bomberi i bronzit'. Mbetet të shihet nëse Wilderi do të nokautohet pas dy raundeve dhe t'i japë fund karrierës së tij.

#### Guardiola: Bëmë gjithçka për fitore, por Crystal Palace mori një pikë

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka thënë se skuadra e tij bëri gjithçka për ta fituar ndeshjen ndaj Crystal Palaces (2-2), por që nuk ia arriti qëllimit. "Ne u përpoqëm të bënim gjithçka për të fituar. Fryma ishte aty. Ne u përpoqëm dhe u përpoqëm. E përmbysëm rezultatin, por prapë kemi lënë pikë. Ky është futboll. Ne kemi luajtur me të njëjtën mënyrë si kemi bërë në 'VillaPark' kundër Aston Villas, me Benjamin Mendy, duke sulmuar nga e majta dhe lojtarët e tjerë në qendër. Vuajtëm pak në 10 minutat e para të pjesës së dytë, por pastaj mendoj se bëmë gjithçka siç duhet. Crystal Palace nuk bëri shumë, por arritën të merrnin një pikë", ka thënë Guardiola.



					<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	KËNGËTARJA NË FOTO	BASHKIMI I HARMONISHËM I DISA TINGUJVE TË NJËKOHSHËM	PJESË E NJË PËLHURË E THYER ME DYSH NË VIJË TË DREJTË (shq.)	MOR, HEJ (pasth.)	KËNGËTARJA E FAMSHME ... KIM	FJALË TINGULLIMIT-UESE (shq.)	RESA, SMIRA	<b>EPOKA E RE</b>	PRINCIPIELE	VEND LUFTIMI I GLADIATORËVE	BARI I THARË	
					MONEDHË E VJETËR ARI ME VLERË PREJ NJËZET FRANGASH								PRAPA				
					VEGËL MUZIKORE								TOKA E BUKËS POEZIA E DASHURISË				
					DETYRË E AKTORIT				KLUB FUTBOLLI NË BELGJIKË SKITAR								
					NËPËR ARA, ARAVE					FLOTA DETARE							
					IVAN DAKUR			BASHKËT. ROYAL POTOGRAPHIC SOCIETY		ERË E MIRË						ARKEOLOGU SKENDER	
					SHTET AZIATIK (pashq.)					TRAJNERI SPANJOLL VILANOVA BASHKËT.					ZANORE KRYEQYTETI KANADEZ		
					BASHKËT.		FUTBOLLISTI I NJOHUR BRAZILIAN ALEXANDRE ANA FARIS					BENDI MUZIKOR ".... MAIDEN" POLITIKANI FERID .....					
<b>EPOKA E RE</b>	VEESHJE E SIPËRME E TRASHË	FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO	I PARI I XHAMISË (pashq.)	ZANORE	<b>EPOKA E RE</b>	MUNDËSI PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT				KUTIA E VOGËL PREJ KARTONI MODEL I ZVOGËLUAR I NJË OBJEKTI							
					PJESË MUZIKORE PËR TRE INSTRUMENTE OSE PËR TRE ZËRA										ARBEN MALAJ DRU I ÇMUESHËM QË PËRDORET PËR ORENDI		
					KORNIZË				REGJISORJA ARZANA VLERA, DOBIA				ISH AKTORJA E FAMSHME GARDNER SHALQI				
					I PESHQJ (bised.)			MODELJA AMERIKANE .... TAYLOR MURI I NDËRTUAR ME DËRRASA		NJERINGR-ENËS BASKETBOLLISTI OBËRTINCA							
					KRYENGRITËSI QË DILTE MALIT E LUFTONTE PËR LIRINË E ATDHEUT			BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA (sh.pashq.) PËRSËRITËS (gram.)				KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK KADRI ZEKA			ZANORE ROK BEND I YNI		
					"OSAKA"				RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE			OKSIGJEN, NITON ANA RUSO				E PËRZJEVE, E TRAZOVE	
<b>EPOKA E RE</b>	KËRCELL I BIMËS SË MISRI	VLERA E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT KUNDREJT ABSOLUTE								JO BASHKËTINGËLLORE I PËSHPËRIT DIKUJT FJALË MAGJIKE							
					DERA E VOGËL E THURUR ME THUPRA								QYTET NË ILIRI I THAJ				
					REOMIR, ERBIUM			ZËRI I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT ARTI I VALLEVE ME FIGURA					BASHKËT. SHTET NË AZI (Pashq.)		JEMENI, ANGOLA VEPËR E KRYER, PUNË		
					SHTET FEDERAL NË SHBA				MËRIA, ZILIA BASKETBOLLISTI TURK .... ONAN					"K" pas dy "A" ARMENIA			
					SPIUNIA E FAMSHME .... HARI			GRIMCË MOLEKULARE GAZ PËR TË PASTRUAR MIRË PLAGËT		KURESHTJE MODELJA KRASNIIQI					ZANORE LUFTËTARI GJERGJ .... ALIA		
					AGIM TEJECI					QYTET NË KROACI DES MOINES UNIVERSITY				VITI I RI KINEZ (pashq.) "N" pas dy "P"			
					BANOR I KINËS				HUMORISTI BAJRAMI NAPOLI, ATALANTA			NDËRMARRJA PRIVATE KALJARI, ATALANTA			LINDA OSAJ RAMADAN AVDIU		
<b>EPOKA E RE</b>	EMËR YNI MASHKULLI BASHKËT.								FSHAT I MADH NË DRENICË TROPOJA				SHKURTOJ, KRASIT DEGËT E NJË PEME				
					CIPA MË E BRENDSHME E KOKËRDHOKUT TË SYRIT (sh.shq.)								KAJDE, OJNA				





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister  
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistiku Kosova - Kosovo  
Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofritit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, **Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:**

**Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

Emri i Institucionit	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>
Titulli i punës:	<b>Anketues për Anketën e Statistikave të Ujërave 2020</b>
Numri i referencës:	<b>ASK-DSBM-002</b>
Tarifa e shërbimit:	<b>I negociuar</b>
Raporton te:	<b>Njësia e Statistikave të Bujqësisë në ASK</b>
Lloji i kontratës:	<b>Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)</b>
Kohëzgjatja e kontratës:	<b>1 muaj (një)</b>
Orari i punës:	<b>I plotë</b>
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	<b>ASK- 8 anketues dhe 1 mbikëqyrës</b>

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Të marrin pjesë në trajnim dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative për realizim e anketës në terren.
- Të bëjnë grumbullimin e të dhënave për anketën vjetore të statistikave të ujërave me pyetësorë.
- Të respektoj udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që janë në pyetësor dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Para largimit nga biznesi i anketuar të bëjnë kontrollimin e pyetësorit të plotësuar për t'u siguruar se të gjitha pyetjet janë plotësuar dhe të gjitha udhëzimet janë ndjekur;
- Përdorimi i adresave dhe të dhënave individuale të bizneseve të cilat duhet të anketohen (sipas listës së bizneseve).
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin e drejtpërdrejt bënë kontrollimin dhe përmirësimin e të dhënave në grumbulluar në pyetësor.
- Të njoftojnë mbikëqyrësit për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe të kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista zhvillohet në gjuhën të cilën e flet ai komunitet.
- Të bëjnë raportimin ditor të mbikëqyrësi (ASK);
- Të përfundojnë Anketën e Statistikave të Ujërave brenda afatit të parashikuar nga ASK.
- Të mbajnë të gjitha informatat e pranuar në bizneset e anketuara si sekret zyrtar.
- Të kthejnë pyetësorët e pranuar nga ASK, pas përfundimit të punës në teren.

**Përgatitja shkollore për anketues/përvoja:**

- Të jenë student ( student të fakultetit ekonomik dhe bujqësisë ) kanë përparësi;
- Të kenë përvojë në anketat e mëparshme në statistikave të mjedisit, të bujqësisë dhe në anketat tjera, e preferuar përvoja në anketat mjedisore dhe të bujqësisë..
- Përparësi kanë kandidatët të cilët kanë kryer nivel më të lartë të shkollimit;

**Kompetenca dhe aftësitë:**

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të jetë i gatshëm të punoj nganjëherë me orë pune më të gjatë përfshi vikendet.
- Të jetë nga regjioni ku kërkohet të zhvillohet anketa.

**Anketa e Statistikave të Ujërave, anketuesit sipas rajoneve**

Rajoni	Anketues	Mbikëqyrës
Prishtina	2	1
Prizreni	1	
Gjakova	1	
Peja	1	
Mitrovica	1	
Ferizaj	1	
Gjilani	1	
<b>Gjithsej</b>	<b>8</b>	

**Kushtet për vendin e punës mbikëqyrës të Anketës së Statistikave të Ujërave 2020.**

- Aplikantët që konkurojnë për këtë vend të punës duhet të kenë të kryer Fakultetin Ekonomik, Fakultetin e Bujqësisë ose të ngjashme (kandidatët me përgatitje me të lartë shkollore kanë përparësi).
- Përvoja e mëparshme në kontrollimin e pyetësorëve të anketave mjedisore është përparësi.
- Të kenë aftësi të mira organizative.
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

**Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK-së.**

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Paraqitja e kërkesave:** Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohet nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/> Aplikacionet dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr. "Zene Salihu" nr.4 Prishtinë.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:** CV<sup>1</sup>, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, vërtetimi nga fakulteti që është student, diploma (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje), si dhe një dëshmi nga përvoja e punës sipas përshkrimit të detyrave të punës (Anketa të statistikave mjedisore dhe të bujqësisë).

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen intervistës me gojë.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149 prej orës 08:00 – 16: 00.

<sup>1</sup> Përfshi: Nr. Telefonit si dhe një adrese elektronike

**Lumë's Details**  
*Estetik & Depilim*

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrypa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister  
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova, raspisuje:

**Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge**

Naziv institucije:	Agencija za Statistiku Kosova
Naziv pozicije:	Anketar za Anketu za Istraživanje Statistike Vode 2020
Referentni broj:	ASK-OSPŽS-002
Tarifa usluga:	Po dogovoru
Izveštava:	Jedinici za Statistiku Poljoprivrede u ASK
Vrsta ugovora:	Sporazum za Posebne Usluge (SPU)
Trajanje ugovora:	Jedan mesec (1)
Radno vreme:	Puno
Lokacija i broj izvršilaca:	ASK-8 anketara i 1 supervizor

**Zadaci i odgovornosti: istraživanje statistike vode**

- Učestvuje u obuci i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim uputstvima za sprovođenje ankete na terenu;
- Prikuplja podatke za godišnju anketu o istraživanje statistike vode putem upitnika;
- Poštuje uputstva upitnika za pitanja koja ne treba postavljati nekim ispitanicima i prati sve procedure i objašnjenja navedena u uputstvima;
- Pre napuštanja domaćinstva kontrolniše popunjeni upitnik da se osigura da su popunjeni svi odgovori na pitanja iz upitnika i sva uputstva praćena;
- Koristi adrese i podatke o pojedinačnim poslovanjima koje treba da budu anketirane i (prema spisku poslovanja).
- U saradnji sa direktnim supervizorom vrši kontrolu i ispravku podataka prikupljenih u upitniku.
- Obavesti supervizora o mogućim problemima i neizvesnostima i traži pomoć ako je potrebno;
- Intervjuisanje se sprovodi na jeziku zajednice kojoj pripada ispitanik;
- Dnevno izveštava svom supervizoru (ASK);
- Da završi Anketu o istraživanje statistike vode u propisanom roku od ASK-a;
- Sve dobijene podatke o anketiranim poslovanjima treba da čuva kao službenu tajnu;
- Nakon završetka rada na terenu vrati primljene upitnike od ASK-a.

**Školska spema za anketara/ iskustvo:**

- Da bude student (studenti ekonomskog i poljoprivrednog fakulteta) imaju prednost;
- iskustvo u prethodnim anketama statistika životne sredine i poljoprivrede i drugim anketama, poželjno iskustvo u anketama životne sredine i poljoprivrede;
- Prednost imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja.

**Kompetencije i veštine:**

- Veštine za veoma dobru saradnju i komunikacije;
- Spreman/na za timski rad;
- Ima dobre organizacione veštine i bude spreman/na da ponekad radi sa dužim radnim vremenom, uključujući i vikendom.
- Da bude iz odgovarajućeg regiona gde će biti sprovedena Anketa

**Anketa za istraživanje vode 2020, anketari prema regionima**

Regioni	Anketari	Supervizori
Priština	2	1
Prizreni	1	
Đakovica	1	
Peć	1	
Mitrovica	1	
Uroševac	1	
Gnjilane	1	
<b>Ukupno</b>	<b>8</b>	

**Uslovi za radno mesto supervizora Ankete za istraživanje vode :**

- Kandidati koji se prijave za ovaj posao moraju imati završeni ekonomski fakultet ili poljoprivrede ili slično (kandidati koji imaju viši nivo obrazovanja imaju prednost).
- Prethodno iskustvo u kontroli upitnika anketa o životnoj sredini je prednost.
- Da ima dobre organizacione veštine.
- Da ima dobre veštine komuniciranja i timskog rada.

**Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na internet stranici ASK-a.**

**Uslovi učešća na konkursu:**

Pravo učešća na konkurs imaju svih punoletni (18 i više godina) građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

**Podnošenje prijave:**

Obrasci za prijavu mogu se dobiti u Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul."Zenel Salihu" br.4, Priština.

**Uz prijavu potrebno je priložiti:**

CV, kopiju lične karte, dokumenat o prebivalištu, potvrda sa fakulteta koja dokazuje da je kandidat student, diplomu (svi dokumenti treba da budu kopije), kao i dokaz o radnom iskustvu prema opisu radnih zadataka (Anketa Statistika životne sredine i poljoprivrede).

I Uključujući:

Nepotpune prijave i one podnete nakon isteka roka neće biti prihvaćene.

Zbog velikog broja primljenih prijava, samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Kandidati koji uđu u uži izbor biće intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona : 038- 200 31 149 od 08:00 – 16: 00 časova.

**RESTAURANT**

**SWISS**  
**TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

**PRISHTINË**



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/giejpuneshpejite](http://www.facebook.com/giejpuneshpejite)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister  
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencijaza Statistiku Kosova - Kosovo  
Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, *Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:*

**Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

Emri i Institucionit	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>
Titulli i punës:	<b>Anketues për Anketën e Mbeturinave Industriale, Anketën e Mbeturinave të Trajtuara dhe Anketën e Mbeturinave Komunale 2020</b>
Numri i referencës:	<b>ASK-DSBM-002</b>
Tarifa e shërbimit:	<b>I negociuar</b>
Raporton te:	<b>Njësia e Statistikave të Bujqësisë në ASK</b>
Lloji i kontratës:	<b>Marrëveshje për Shërbime të Veçanta-(MSHV)</b>
Kohëzgjatja e kontratës:	<b>1 muaj (një)</b>
Orari i punës:	<b>I plotë</b>
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	<b>ASK- 10 anketues dhe 1 mbikëqyrës</b>

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Të marrin pjesë në trajnim dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative për realizim e anketës ne terren.
- Të bëjnë grumbullimin e të dhënave për anketën vjetore të mbeturinave industriale me pyetësorë.
- Të respektoj udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që janë ne pyetësor dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përshkruara në udhëzime;
- Para largimit nga biznesi i anketuar të bëjnë kontrollimin e pyetësorit të plotësuar për t'u siguruar se të gjitha pyetjet janë plotësuar dhe të gjitha udhëzimet janë ndjekur;
- Përdorimi i adresave dhe te dhënave individuale te bizneseve te cilat duhet te anketohen (sipas listës se bizneseve).
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin e drejtpërdrejt bënë kontrollimin dhe përmirësimin e të dhënave në grumbulluar ne pyetësor.
- Të njoftojnë mbikëqyrësit për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe të kërkojnë ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista zhvillohet në gjuhën të cilën e flet ai komunitet.
- Të bëjnë raportimin ditor të mbikëqyrësi (ASK);
- Të përfundojë Anketën e Mbeturinave Industriale brenda afatit të parashikuar nga ASK.
- Të përfundojë Anketën e Mbeturinave të Trajtuara brenda afatit të parashikuar nga ASK
- Të përfundojë Anketën e Mbeturinave Komunale brenda afatit të parashikuar nga ASK
- Të mbajë të gjitha informatat e pranuar në bizneset e anketuara si sekret zyrtar.
- Të ktheje pyetësorët e pranuar nga ASK , pas përfundimit të punës në teren.

**Përgatitja shkollore për anketues/përvoja:**

- Të jenë student ( studentët e fakultetit ekonomik dhe bujqësisë ) kanë përparësi;
- Të kenë përvojë në anketat e mëparshme në statistikë e mjedisit, të bujqësisë dhe në anketat tjera, e preferuar përvoja në anketat mjedisore dhe të bujqësisë..
- Përparësi kanë kandidatet të cilët kanë kryer nivel më të lartë të shkollimit;

**Kompetenca dhe aftësitë:**

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të jetë i gatshëm të punoj nganjëherë me orë pune më të gjatë përfshi vikendet.
- Të jetë nga regjioni ku kërkohet të zhvillohet Anketa.

**Anketa e Mbeturinave Industriale 2020, anketuesit sipas rajoneve**

Rajoni	Anketues	Mbikëqyrës
Prishtina	3	1
Prizreni	1	
Gjakova	1	
Peja	1	
Mitrovica	1	
Ferizaj	1	
Gjilani	1	
Gjithsej	9	

**Anketa e Mbeturinave të Trajtuara dhe Anketa e Mbeturinave Komunale 2020, anketues sipas rajoneve**

Rajoni	Anketues
Prishtina	1
Prizreni	
Gjakova	
Peja	
Mitrovica	
Ferizaj	
Gjilani	
Gjithsej	1

**Kushtet për vendin e punës mbikëqyrës të Anketës së Mbeturinave Industriale, Anketës së Mbeturinave Komunale dhe të Anketës së Mbeturinave të Trajtuara 2020.**

- Aplikantët që konkurojnë për këtë vend të punës duhet të kenë të kryer Fakultetin e Bujqësisë, Fakultetin Ekonomik ose te ngjashme (kandidatët me përgatitje me te lartë shkollore kanë përparësi).
- Përvoja e mëparshme në kontrollimin e pyetësorëve të anketave mjedisore është përparësi.
- Të kenë aftësi të mira organizative.
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

**Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK-së.**

**Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Paraqitja e kërkesave:** Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohet nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/> Aplikacionet dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr. "Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:** CV<sup>1</sup>, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, vërtetimi nga fakulteti që është student, diploma (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje), si dhe një dëshmi nga përvoja e punës sipas përshkrimit të detyrave të punës (Anketa të statistikave mjedisore dhe të bujqësisë). Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrihen intervistës me gojë.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149 prej orës 08:00 – 16: 00.

<sup>1</sup> Përfshi: Nr. Telefonit si dhe një adrese elektronike

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Ar Beton" sh.p.k Istog, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për thërrmimin dhe seperimin e rërës dhe zhavorrit në Lubozhdë komuna e Istogut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.02.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Felix Events" afër stadiumit të qytetit në Istog do të organizohet debat publik nga kompania "Ar Beton" sh.p.k Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për thërrmimin dhe seperimin e rërës dhe zhavorrit në Lubozhdë komuna e Istogut.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister  
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova, raspisuje:

**Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge**

Naziv institucije:	<b>Agencija za Statistiku Kosova</b>
Naziv pozicije:	<b>Anketar za Anketu o Industrijskom Otpadu i Anketu o Odrađenom Otpadu i Anketu za komunlani otpada 2020</b>
Referentni broj:	<b>ASK-OSPŽS-002</b>
Tarifa usluga:	<b>Po dogovoru</b>
Izveštava:	<b>Jedinici za Statistiku Poljoprivrede u ASK</b>
Vrsta ugovora:	<b>Sporazum za Posebne Usluge-(SPU)</b>
Trajanje ugovora:	<b>Jedan mesec (1)</b>
Radno vreme:	<b>Puno</b>
Lokacija i broj izvršilaca:	<b>ASK-10 anketara i 1 supervizor</b>

**Zadaci i odgovornosti:**

- Učestvuje u obuci i upozna se sa Metodološkim i Organizacionim uputstvima za sprovođenje ankete na terenu;
- Prikuplja podatke za godišnju anketu o industrijskom otpadu putem upitnika;
- Poštuje uputstva upitnika za pitanja koja ne treba postavljati nekim ispitanicima i prati sve procedure i objašnjenja navedena u uputstvima;
- Pre napuštanja domaćinstva kontroliše popunjeni upitnik da se osigura da su popunjeni svi odgovori na pitanja iz upitnika i sva uputstva praćena;
- Koristi adrese i podatke o pojedinačnim poslovanjima koje treba da budu anketirane i (prema spisku poslovanja).
- U saradnji sa direktnim supervizorom vrši kontrolu i ispravku podataka prikupljenih u upitniku.
- Obavesti supervizora o mogućim problemima i neizvesnostima i traži pomoć ako je potrebno;
- Intervjuisanje se sprovodi na jeziku zajednice kojoj pripada ispitanik;
- Dnevno izveštava svom supervizoru (ASK);
- Da završi Anketu o Industrijskom Otpadu u propisanom roku od ASK-a;
- Sve dobijene podatke o anketiranim poslovanjima treba da čuva kao službenu tajnu;
- Nakon završetka rada na terenu vrati primljene upitnike od ASK-a.

**Školska sperma za anketara/ iskustvo:**

- Da bude student (studenti ekonomskog i poljoprivrednog fakulteta) imaju prednost;
- iskustvo u prethodnim anketama statistika životne sredine i poljoprivrede i drugim anketama, poželjno iskustvo u anketama životne sredine i poljoprivrede;
- Prednost imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja.

**Kompetencije i veštine:**

- Veštine za veoma dobru saradnju i komunikacije;
- Spreman/na za timski rad; Ima dobre organizacione veštine i bude spreman/na da ponekad radi sa dužim radnim vremenom, uključujući i vikendom.
- Da bude iz odgovarajućeg regiona gde će biti sprovedena Anketu

**Anketa o Industrijskom Otpadu 2020, anketari prema regionima**

Regioni	Anketari	Supervizori
Priština	3	1
Prizreni	1	
Đakovica	1	
Peć	1	
Mitrovica	1	
Uroševac	1	
Gnjilane	1	
<b>Ukupno</b>	<b>9</b>	

Anketa o Odrađenom Otpadu i Komunalni otpada 2020, anketari prema regionima

Regioni	Anketari	
Priština	1	
Prizreni		
Đakovica		
Peć		
Mitrovica		
Uroševac		
Gnjilane		
<b>Ukupno</b>		<b>1</b>

**Uslovi za radno mesto supervizora Ankete o Industrijskom Otpadu i Anketu o Odrađenom Otpadu.**

- Kandidati koji se prijave za ovaj posao moraju imati završeni fakultet biologije ili poljoprivrede ili slično (kandidati koji imaju viši nivo obrazovanja imaju prednost).
- Prethodno iskustvo u kontroli upitnika anketa o životnoj sredini je prednost.
- Da ima dobre organizacione veštine.
- Da ima dobre veštine komuniciranja i timskog rada.

**Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na internet stranici ASK-a.**

**Uslovi učešća na konkursu:**

Pravo učešća na konkurs imaju svih punoletni (18 i više godina) građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

**Podnošenje prijave:**

Obrasci za prijavu mogu se dobiti u Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul. "Zenel Salihu" br.4, Priština.

**Uz prijavu potrebno je priložiti:** CV1, kopiju lične karte, dokumenat o prebivalištu, potvrda sa fakulteta koja dokazuje da je kandidat student, diplomu (svi dokumenti treba da budu kopije), kao i dokaz o radnom iskustvu prema opisu radnih zadataka (Anketa Statistika životne sredine i poljoprivrede).

I Uključujući:

Nepotpune prijave i one podnete nakon isteka roka neće biti prihvaćene.

Zbog velikog broja primljenih prijava, samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Kandidati koji uđu u uži izbor biće intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038- 200 31 149 od 08:00 – 16: 00 časova.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Vullnet Mucaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Naim Meta shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni " Prizren

► Adnan Qehaja shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Sejdi Bicaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Motrat Qirazi" Prizren

► Artan Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Dëshmorët e Zhurit" Zhur

► Xheladin Nuredini shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Drita Cejku shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Egzon Shala shpell te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistranja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.  
Tel. 044-413-197.